



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT Durrës

Nr. ____ Prot.

Durrës, më _____.____.2023

Lënda: Raporti dhe informimi mbi veprimtarinë e Prefektit të Qarkut për muajt Janar-Dhjetor.

MINISTRISË SË BRENDSHME
DREJTORISË SË POLITIKAVE TË ÇËSHTJEVE VENDORE

TIRANË

Në mbështetje të Ligjit Nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut" dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore që kanë të bëjnë me veprimtarinë e Prefektit të Qarkut dhe në zbatim të Urdhërit të Ministrit të Brendshëm, Nr.667 datë 18.12.2014 "Për raportimin dhe informimin mbi veprimtarinë e Prefektit të Qarkut." po Ju dërgojmë raportin në lidhje me veprimtarinë e Prefektit të Qarkut Durrës për muajt Janar-Dhjetor 2022.

Gjatë këtij viti Prefekti i Qarkut Durrës ka organizuar punën duke u përqëndruar kryesisht në këto drejtime:

I. Marrëdhëniet e Prefektit të qarkut me Administratën e Shtetërore:

INFRASTRUKTURA

Gjatë vitit 2022 i është kushtuar rëndësi të veçantë infrastrukturës në nivel qarku, kryesisht të infrastrukturës rrugore në sigurinë e rrugëve nacionale dhe atyre rurale vendore. Në këtë kontekst përgjatë gjithë vitit janë zhvilluar takime të ndryshme me të gjithë strukturat përkatëse si dhe janë trajtuar dhe ndjekur çështje dhe problematika që kanë të bëjnë me infrastrukturën rrugore dhe të gjithë elementët e tyre në drejtim të sigurisë. Përveç takimeve të ngushta me struktura sipas problematikave të ndeshura në drejtim të infrastrukturës rrugore, gjatë vitit 2022 janë zhvilluar 3 takime të rëndësishme me të gjithë aktorët përgjegjës ndër të cilët përmendim:

- **Takimi i datës 17.02.202** ku Prefekti i Qarkut Durrës zhvilloi një takim me të gjithë aktorët përgjegjës për sa i përket situatës së rrugëve nacionale dhe rurale në qarkun Durrës. Në këtë takim të pranishëm ishin; Drejtori i Drejtorisë së Rajonit Qëndror Tiranë pranë ARRSH, shefi i sektorit të Policisë Rrugore pranë Policisë Vendore Durrës, Drejtori i Policisë Bashkiake, përfaqësues të Sektorit të Shërbimeve Bashkia Durrës, N/Kryetarja e Bashkisë Shijak dhe përfaqësues të Sektorit të Shërbimeve Bashkia Shijak, përfaqësues të Bashkisë Krujë drejtori i shërbimeve dhe investimeve publike dhe përgjegjësi i sektorit të rrugëve rurale, Drejtori i Ndërmarrjes së Shërbimeve Komunale Durrës, Drejtori i Ndërmarrjes së Shërbimeve Komunale Plazh, përfaqësues nga Ndërmarrjes Rruga.

Ndër çështjet e diskutuara në këtë takim ishin analizimi i situatës së përgjithshme të rrugëve të qarkut Durrës, mirëmbajtjes dhe sigurisë në akset rrugore të qarkut Durrës, problematikat, pikat e nxehta, përmirësimi i sinjalistikës etj. Masat e marra dhe që do të merreshin në vazhdimësi në kuadër të parapregatitjes për sezonin e ri turistik 2022.

Një çështje e rëndësishme ishte dhe ecuria e punës nga bashkitë e qarkut Durrës dhe ARRSH në realizimin e procesit të kalimit të pronësisë së disa rrugëve. kjo në zbatim të VKM-së Nr.600, datë 13.10.2021, "Për pronësinë e rrugëve shtetërore dhe kalimet e pronësisë ndërmjet enteve pronare të rrugëve".

Disa nga problematikat që u diskutuan dhe detyrat që u lanë në këtë takim janë:

- Njësitë e Vetqeverisjes Vendore të bashkëpunonin me strukturat përgjegjëse të ARRSH për përfundimin e procedurave të kalimit ligjor të rrugëve në zbatim të VKM Nr.600, datë 13.10.2021, "Për pronësinë e rrugëve shtetërore dhe kalimet e pronësisë ndërmjet enteve pronare të rrugëve".
- Njësitë e Vetqeverisjes Vendore duhet të rishikojnë buxhetet për mirëmbajtjen e rrugëve që i kanë kaluar atyre në pronësi në zbatim të VKM-së Nr.600, datë 13.10.2021 "Për pronësinë e rrugëve shtetërore dhe kalimet e pronësisë ndërmjet enteve pronare të rrugëve", pasi kryerja e kalimit të pronësisë tashmë ishte vetëm një akt ligjor përfundimtar.
- Nga shefi i policisë së qarkullimit rrugorë iu kërkua përfaqësuesve të Njësive të Vetqeverisjes Vendore që të dërgonin informacion të saktë në lidhje me inventarin e rrugëve në mënyrë që të inspektohen përsa i përket sinjalistikës.
- Një problematikë e rëndësishme e evidentuar nga strukturat e Policisë së Qarkullimit Rrugor pranë DVP është heqja e të gjitha reklamave, gardheve, mureve të paligjshme në pjesët e autostradës Durrës-Mamurras dhe në akset rrugore kryesore si dhe mbylljet e daljeve të jashtëligjshme në këto akse kjo në bashkëpunim me ARRSH, gjë për të cilën u kërkua bashkëpunim edhe me IKMT dhe NjVVQ-të.
- Për aksin nga ura e Fush Krujës deri në Tapizë ka përfunduar studimi i rrugës dhe problemi qëndron se po pritet lëvrimi i fondit që rruga të pajiset me sinjalistikën e duhur.

- Nga Drejtori i Shërbimeve Komunale Plazh u ngrit problematika se nga aksidentet që ndodhin në rrugë kemi dëmtime të shumta të kazaneve të plehrave, pemëve, barrierave anësore dhe nuk meret dëmshpërblimi i duhur nga siguracionet dhe si pasojë ngelin të pa rregulluara. Shefi i policisë kërkoi që sa herë të ketë prishje të objekteve në rrugë nga aksidentet automobilistike, të bëhet një kërkesë në polici për dokumentacionin e nevojshëm, mbi rastin e atij aksidenti, që duhet të dërgohet te sigurimi përkatës për të marrë dëmshpërblimin e duhur për dëmtimin e bërë që objekti të rregullohet dhe të rikthehet në gjëndjen e mëparshme.

Nga Prefekti i Qarkut lidhur me të gjitha çështjet dhe problematikat e ngritura u lanë detyra konkrete për aktorët përgjegjës.

Takimi i datës 10.05.2022 ku Prefekti i Qarkut Durrës zhvilloi një takim me të gjithë aktorët përgjegjës për sa i përket gjëndjes së infrastrukturës rrugore në rrugët nacionale dhe rurale në qarkun Durrës si dhe Planit Kombëtarë të Pastrimit në kuadër të parapërgatitjes për sezonin turistik verorë 2022. Në këtë takim ishin të pranishëm: Nënkryetari i Bashkisë Durrës, Drejtori i Drejtorisë së Rajonit Qëndror Tiranë pranë ARRSH, shefi i sektorit të Policisë Rrugore pranë Policisë Vendore Durrës, Drejtori i Policisë Bashkiake, Drejtori i Shërbimeve dhe Investimeve Publike dhe Drejtori i Rrugëve Rurale Bashkia Krujë, Drejtori i Ndërmarrjes së Shërbimeve Komunale Durrës, Drejtori i Ndërmarrjes Rrugë, Drejtori Rajonal i IKMT-së. Gjatë mbledhjes u diskutuan problematikat kryesore të rrugëve të qarkut Durrës, mirëmbajtja dhe siguria në akset rrugore, problematikat, pikat e nxehta dhe përmirësimi i sinjalistikës. Ndër të tjera u diskutuan masat e marra dhe që do të merren në vazhdimësi në kuadër të parapërgatitjes për sezonin e ri turistik 2022 sidomos në rrugët që të cojnë në zonat turistike (investimet, mirëmbajtja, sinjalistika, ndërhyrje, problematikat që paraqiten në to).

Një çështje e rëndësishme dhe që duhet të përfundojë sa më shpejt është zbatimi i VKM-së Nr.600, datë 13.10.2021, "Për pronësinë e rrugëve shtetërore dhe kalimet e pronësisë ndërmjet enteve pronare të rrugëve", për të cilën vetëm Bashkia Krujë e ka mbyllur këtë proces ku Prefekti u la detyrë përfaqësuesve të tjerë të Bashkive të bashkëpunojnë me strukturat përgjegjëse të ARRSH për përfundimin sa më parë të procedurave të kalimin ligjor të rrugëve të përcaktuara në këtë VKM

Nga të pranishmit në takim u diskutuan problematika aktuale që prekin segmentët rrugorë të qarkut tonësi p.sh. rifreskimi i vijëzimeve dhe tabelave sinjalistika e nevojshme në to; menaxhimi i trafikut sidomos në akset rrugore drejtë destinacioneve turistike të qarkut kryesisht në zonat bregdetare. Drejtori i Policisë Bashkiake Durrës u shpreh se janë duke bashkëpunuar me Policinë e Shtetit në një projekt që do t'i lejojë të hyjnë në sistemin e tyre për vendosjen e gjobave gjë e cila do të ndihmonte në menaxhimin e lëvizjes së mjeteve dhe shmangjen e rasteve të shkeljeve të rregullave të qarkullimit rrugor.

Takimi i datë 16.11.2022 - Prefekti i Qarkut Durrës zhvilloi një takim me të gjithë aktorët përgjegjës për sa i përket situatës së rrugëve nacionale dhe rurale në qarkun Durrës.

Të pranishëm ishin: Drejtori i Drejtorisë së Rajonit Qëndror Tiranë pranë ARRSH, Drejtori i Ndërmarrjes Rrugë dhe përfaqësues të firmave kontraktuese nga ARRSH të mirëmbajtes së

rrugëve të Qarkut, Nën/Kryetari i Bashkisë Durrës, Shefi i Sektorit të Policisë Rrugore pranë Policisë Vendore Durrës, Drejtori i Policisë Bashkiake, përfaqësuese nga Drejtoria e Shërbimeve Publike Durrës, Drejtori i Shërbimeve dhe Investimeve Publike Krujë, përfaqësues i Drejtorisë së Rrugëve Rurale Krujë, Përgjegjësi i sektorit të mbrojtjes civile Krujë, Drejtori i Ndërmarrjes së Shërbimeve Komunale Durrës, Drejtori i Ndërmarrjes së Shërbimeve Komunale Plazh.

Gjatë kësaj mbledhjeje u diskutuan problematikat kryesore të rrugëve, mirëmbajtja dhe siguria në akset rrugore, pikat e nxehta dhe përmirësimi i sinjalistikës, dhe masat që do të merren në vazhdimësi në kuadër të parapregatitjes për sezonin vjeshtë-dimër (2022-2023).

Në raportimin që u bë në lidhje me zbatimin e VKM-së Nr.600, datë 13.10.2021, "Për pronësinë e rrugëve shtetërore dhe kalimet e pronësisë ndërmjet enteve pronare të rrugëve", Bashkia Durrës e kishte përfunduar këtë proces kalimi me ARRSH-në. Mbetet ende Bashkia Shijak për zbatim e këtij vendimi.

Gjithashtu u diskutuan investimet dhe ndërhyrjet e ndryshme që janë bërë gjatë kësaj periudhe apo që parashikohen të bëhen gjatë vitit 2023 në përmirësimin e situatës së rrugëve nacionale dhe rurale. Një pikë tjetër e rëndësishme ishte dhe vlerësimi i ecurisë së zbatimit të Planit Kombëtar të Pastrimit në Qarkun Durrës. Në këtë takim, Prefekti theksoi rëndësinë e bashkëpunimit dhe kërkoi që të merren të gjitha masat e domosdoshme për problematikat e diskutuara.

INVESTIMET NË INFRASTRUKTURËN RRUGORË NË QARKUN DURRËS

Gjatë vitit 2022 një vëmendje e veçantë i është kushtuar ndjekjes dhe monitorimit të shërbimeve apo investimeve të ndryshme të kryera nga bashkitë apo strukturat mbështetëse në drejtim të infrastrukturës rrugore. Është kryer rehabilitimi i infrastrukturës rrugore, kuartallave, trotuareve në lagje të ndryshme të qytetit të Durrësit, shtrim me asfalt i disa rrugëve **në Bashkinë Durrës nga Ndërmarrja Rruga**. Janë kryer pastrime, larje të rrugëve dhe trotuareve si edhe rinovim të sinjalistikës horizontale në rrugët e qytetit me qëllim rritjen e sigurisë për këmbësorët por dhe drejtuesit e mjeteve.

Rehabilitimi i rrugës “Kastrioti” në lagjen 8 në Bashkinë Durrës ku është asfaltuar një sipërfaqe prej 1800 m² si dhe është vendosur sinjalistika horizontale.

Po kështu në rrugën “Vllazërimi” e cila është e ndriçuar e gjitha me LED si dhe zëvendësimi i semaforit ekzistues me një semafor i ri me drita LED

Asfaltimi i rrugës “Kodra e Kuajve” në fshatin Shkallnur në Njësinë Administrative të Rrashbullit, asfaltimi i rrugës “22 Marsi” në zonën e plazhit, asfaltimin e rrugëve "Anton Xanoni" dhe "Kadri Pirro" në lagjen nr. 5,

Rehabilitimi i një kuartalli në lagjen nr. 7 të qytetit të Durrësit, ku është asfaltuar e gjithë sipërfaqja dhe vendosja e sinjalistikës vertikale dhe horizontale.

Asfaltimi i rrugëve “Andon Boshnjaku” dhe "Mbreti Gjin" në brendësi të zonës së plazhit si dhe rruga "Dom Nikoll Kaçorri" në lagjen nr. 3; asfaltimi dhe vendosja e sinjalistikës horizontale e një

rruge kryesore në Manëz; rikonstruksioni i rrugës në zonën e Gjirit të Lalëzit; asfaltimi i rrugës “Manastiri” në Shën Vlash;

Rehabilitimi i një kuartalli me sipërfaqe 850 m² në lagjen 1 të qytetit; asfaltimi i rrugës "Integrimi" në Spitallë; asfaltimi i hapësirave midis pallateve në brendësi të lagjes 1 të qytetit ku është asfaltuar një sipërfaqe prej 1200 m² ndërkohë që po punohet të vendoset edhe ndriçimi si dhe sinjalistika horizontale dhe vertikale; rehabilitimi i një rruge në Shkallnuri në Njësinë Administrative të Rrashbullit e cila i shërben jo vetëm banorëve por edhe bizneseve të zonës; asfaltimin e rrugës “Xhemal Tirana” në lagjen 15 në Spitallë, rikonstruksionin e rrugës “Princ Vidi” në zonën e Spitallës, rehabilitimin e rrugës "Epikadeve" në lagjen 1 ku është asfaltuar një sipërfaqe prej 1000 m² si dhe do të vendoset sinjalistika horizontale e vertikale, asfaltimin e kuartallit pranë kopshtit "1 Maji" me sipërfaqe 450 m², rehabilitimin e trotuarëve në lagjen 14 në Shkozë, ndjekjen e punimeve të Lotit 3 në zonën e Porto Romano ku ka përfunduar shtresat asfaltike dhe rruga po bëhet gati për vijëzimin përfundimtar, asfaltimin e rrugës "Miqësia".

Në Bashkinë Krujë janë ndjekur dhe monitoruar disa investime në drejtim të përmirësimit të infrastrukturës rrugore në këtë bashki ku përgjatë vitit 2022 përmendim:

Riasfaltimi i Rrugës “Shelqet” në Nikël, rikonstruksioni i “Rrugës së Albanopolisit” zona e Krujës etj. Në Krujë ka nisur faza e parë e punimeve në rrugën Barun për të cilën do të investohet në 2 faza pune për të asfaltuar të gjithë rrugën pasi ka gjatësi të konsiderueshme.

Rikonstruksioni i rrugës “Dashamiri”, “Hekurudha” dhe “Vlash Dobrozi” në zonën e Thumanës, rehabilitimi i segmentit të unazës së vogël në Fushë-Krujë, shtrimi në Rinas i një tjetër segmenti rrugor, i cili lehtëson lëvizjen e mjeteve drejt Aeroportit “Nënë Tereza”, sistemimin dhe asfaltimin e rrugëve brenda lagjeve Zallë-Fushë Krujë, asfaltimi i rrugës “Vlash Dobrozi”, në Bushnesh, Thumanë; rikonstruksioni i rrugës në fshatin Hasan zona e Fushë Krujës me një gjatësi prej 2,5 km, asfaltimi i rrugëve brenda lagjeve në zonën e Fushë Krujës, asfaltimin e një tjetër segmenti rrugor brenda lagjeve të Krujës, rruga Shullaz.

Të gjitha këto shërbime, ndërhyrje dhe investime tregojnë për një vëmendje të shtuar të këtyre bashkive në planifikimin dhe alokimin e fondeve në drejtim të përmirësimit të infrastrukturës rrugore, rritjes së cilësisë dhe sigurisë e edhe pse mund të themi që duhet të bëhet edhe më tepër në këtë drejtim nga bashkitë.

Problematikat kryesore të infrastrukturës rrugore të evidentuara gjatë vitit 2022 nga Institucioni i Prefektit.

1. Mungesa e sinjalistikës si vertikale ashtu dhe ajo horizontale, vijëzimeve, në disa rrugë të bashkive dhe në periferi të tyre.
2. Probleme në mirëmbajtjen e rrugëve nga strukturat përgjegjëse të Bashkisë në rrugët në varësi të tyre, por gjithashtu edhe nga firmat kontraktore në rrugët nën administrimin e ARRSH, vonesa në riparimin në kohë të tyre sidomos kjo në fazën parapërgatitore për sezonin turistik veror apo edhe në parapërgatitjet për sezonin vjesht-dimër.

3. Nevoja për studimin dhe hartimin e projektit teknik të rrugëve të cilat kanë nevojë për pajisje me sinjalistikën e duhur (vertikale) aty ku mungojne, kërkesë e parashtruar nga Drejtoria e Rajonit Qëndror pranë ARRSH-së në mënyrë që kjo e fundit të mundsojë plotësimin e këtyre nevojave me këtë sinjalistikë.
4. Prishja e barrierave anësore të rrugëve, kazanëve të mbetjeve, pemëve, sinjalistikës nga aksidentet, dhe nuk merren përgjegjësi nga dëmtuesi dhe masa në kohë për rregullimin e tyre (këto ndodhin për arsye teknike por edhe çështje fondesh).
5. Menaxhimi jo i mirë i trafikut gjatë sezonit verorë si dhe atij të fundvitit, mospërdorimi i rrugëve alternative.
6. Problematike paraqitet gjendja e rrugëve të brendshme të fshatrave, apo edhe e atyre që i lidhin ata me njëri tjerin. Disa prej tyre kanë nevojë për rikonstruksion ose rregullim tërësor me të gjithë elementët përbërës si ndriçim, sinjalistikë, korsi për transport alternativ, si dhe infrastrukturë nëntokësore elektrike apo hidraulike.
7. Mungesa e kamerave të monitorimit të trafikut në disa akse kryesore të qyteteve për të normalizuar fluksin e qarkullimit të automjeteve, parandaluar vjedhjet e kablllove të ndriçimit, kundravajtjeve, motorëve që lëvizin me shpejtësi gjatë natës etj.
8. Mospërfundimi ende i procesit të kalimit të rrugëve nga ARRSH te Bashkia Shijak, kjo në zbatim të VKM-së Nr.600, datë 13.10.2021, "Për pronësinë e rrugëve shtetërore dhe kalimet e pronësisë ndërmjet enteve pronare të rrugëve"

Objektivat e punës së Prefektit të Qarkut për vitin 2023 në drejtim të infrastrukturës

1. Ndjekja e problemeve dhe organizimi i takimeve mbi marrjen e masave nga të gjithë strukturat përgjegjëse për infrastrukturën rrugore, sigurinë dhe pajisjen me sinjalistikën e duhur, rikonstruksionit në kohë të akseve të dëmtuara dhe sigurimit të elementëve të tjerë për të pasur një siguri maksimale të rrugëve në qark.
2. Marrjen e masave për rritjen e performancës në drejtim të pastrimit të rrugëve, pastrimit të drenazheve, pastrimin e vegjetacionit, mirëmbajtjen e veprave të artit, mirëmbajtjen e sinjalistikës etj.
3. Vëmendje do ti kushtohet edhe monitorimit të punës për ndriçimin e akseve rrugore, zëvendësimit të ndriçimit të vjetër me atë LED si dhe shtimit në akse të tjera brenda dhe jashtë qyteteve, për të rritur cilësinë e ndriçimit, kursimin e energjisë si dhe për të shtuar sigurinë.
4. Monitorimi i investimeve rrugore dhe prioritizimi i punës së tyre në drejtim të krijimit të rrugëve alternative dhe me një sens lëvizje siç janë ; Rruga dytësore Plepa-Golem, Durrës-Curila, Maminas-Gjiri i Lalëzit etj.
5. Angazhimi i Institucionit të Prefektit në nxitjen e realizimit të një studimit dhe projekti teknik të përgjithshëm dhe të detajuar për qarkullimin e automjeteve në akset rrugore të qytetit të Durrësit, kjo në funksion të përmirësimit të qarkullimit të automjeteve dhe këmbësorëve brenda

territorit të bashkisë Durrës. Kjo çështje është diskutuar vazhdimisht në takimet që janë zhvilluar dhe duke qënë se ka një praktikë tashmë të mirë dhe funksionale pasi ajo është aplikuar në disa akse rrugore të qytetit në lëvizjen e mjeteve me një sens qarkullimi, duke shmangur kështu ngarkesat, problemakriten e trafikut në këto akse, por edhe aksidentet e mundëshme në to. Duhet një bashkëpunim dhe koordinim sa më i mirë i punës së strukturave në disiplinimin e trafikut, mjeteve dhe këmbësorëve në mënyrë të veçantë në periudha piku apo dhe në ato zona apo akse të ngarkuara.

6. Vëmendje do ti kushtohet fushatave ndërgjegjëse por edhe ndëshkuese nga të gjithë strukturat përgjegjëse në raport me qytetarët në respektimin e rregullave të lëvizjes së tyre, respektimi i semaforëve, ecja në vijat e bardha apo përdorimi i mbikalimeve si dhe në raport me mjetet qarkulluese në respektimin e shpjëtësisë (uljen e saj në qytet), vendosjen e rripit, mos përdorimin e celularit gjatë ngarjes së makinës, respektimi i rregullave të lëvizjes në rrethrotullime etj etj, cka përbëjnë preçedcën kryesore për burim aksidentesh.
7. Angazhimin në përfundimin ligjorë të proçesit të kalimit të rrugëve nga ARRSH te Bashkia Shijak dhe anasjelltas, si dhe vëmendja që duhet të tregojnë këto bashki në mirëmbajtjen në kushte optimale të tyre.

ENERGJIA ELEKTRIKE

Energjia Elektrike si një nga produktet dhe shërbimet më të rëndësishme jo vetëm për individët por edhe në zhvillimin ekonomik të vendit ka qënë prioritet i vëmëndjes së Prefektit të Qarkut. Kjo gjë është bërë duke ndjekur dhe monitoruar punën e Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE-së) dega Durrës, si dhe implementimin e politikave të ndërmarra nga qeveria shqiptare për menaxhimin sa më të mire.

Për këtë gjatë viti 2022 janë zhvilluar disa takime me drejtues dhe teknikë të OSHEE-së dega Durrës për t'u njohur me situatën dhe menaxhimin e këtij sektori në qarkun tonë, njohja me gjendjen aktuale të ecurisë së situatës energjitike, investimet e ndryshme, problematikat, niveli i arkëtimit në nivel qarku etj. Përgjatë gjithë vitit janë marrë informacione në mënyrë periodike mbi situatën e furnizimit, difektet dhe remontet e kryera nga strukturat e OSHEE-së.

Viti 2022 ka qënë një vit i vështirë kjo si rezultat i pandemisë apo dhe luftës në Ukrainë. Në mënyrë të veçantë në fokus të punës tonë ka qënë edhe menaxhimi i situatës elektro-energjitike. Nga grupet teknike është ndërhyrë në kohë për eliminimin e difekteve të ndodhura për shkakë klimaterike apo edhe defekteve ne rrjet. Është ndjekur dhe monitoruar situata e furnizimit me energji elektrike në mënyrë që të kishim një një menaxhim sa më të mirë të sezonit të ri turistik veror 2022, në drejtim të ofrimit të këtij shërbimi, ku një faktorë i rëndësishëm ka qënë mbështetja e qeverisë me fondet e buxhetit të sektorit të energjisë elektrike, nëpërmjet garancive shtetërore për kompanitë energjetike që çmimit i energjisë të mos rritet dhe në këtë mënyrë të mos kishte impakt negativ si në biznese ashtu edhe në konsumatorët familjarë.

Në vëmendje kemi pasur edhe vendimet e qeverisë mbi kërkesën e Entit Rregullator të Energjisë ku pas muajit Nëntor 2022 do të hynte në fuqi aplikimi i fashës 800 KW/h, sipas të cilit familjet që

tejkalojnë këtë fashë, energjinë do të paguajnë me çmimin e tregut, gjë e cila deri tani nuk është aplikuar falë një menaxhimi të mirë të situatës hidroenergjitike nga qeveria.

Në kuadër të kursimit dhe menaxhimit të energjisë elektrike është ndjekur dhe monitoruar nisma të qeverise për subvencionimin në masën 70 % të kostos së instalimit të paneleve diellore për ngrohjen e ujit nga klientët familjarë, kjo dhe për të rritur ndërgjegjësimin për përdorimin e paneleve diellore.

Ndër të tjera janë ndjekur dhe monitoruar investimet e ndryshme në mënyrë të veçantë nga Bashkia Durrës në drejtim të uljes së konsumit të energjisë elektrike. Kështu në shumë rrugë të qyteteve ka pasur investime të shumta për zëvendësimin e ndriçimit të vjetër me atë të teknologjisë LED, gjë e cila padyshim ka ndryshuar imazhin e zonës, kuryer energjinë elektrike në përgjigje të krizës si dhe shtuar sigurinë e mjeteve dhe këmbësorëve në to.

Vëmendje të veçantë ka patur edhe nisja e projektit pilot për zëvendësimin e pompave në impiantin e trajtimit të ujërave të zeza për zonën Durrës-Golem. Zëvendësimi i pompave të vjetra me konsum të lartë energjie me ato të reja, ka ndihmuar në rritjen e efikasitetit të energjisë elektrike, duke ulur ndjeshëm konsumin e tyre.

MJEDISI

Mjedisi ka qënë prioritet i punës tonë përgjatë vitit 2022, kjo jo vetëm në ndjekjen, monitorimin e situatës në qarkun tonë por edhe koordinimin dhe bashkërendimin e punës për çdo problematikë të dalë në këtë drejtim. Gjatë viti 2022 janë zhvilluar takime, trajnime të ndryshme sipas specifikës, janë hartuar plane veprimi në drejtim të pastrimit të territorit duke angazhuar jo vetëm strukturat përgjegjëse por edhe shoqërinë civile e më gjerë. Aksionet e pastrimit janë zhvilluar në drejtim të lënies së detyrave nga Kryeministri për pastrimin dhe higjienizimin e territorit nëpërmjet aksioneve të ndryshme të cilat kanë qënë përgjatë gjithë vitit 2022 në të gjithë territorin e qarkut Durrës. Kështu në zbatim të nismës së Kryeministrit të Shqipërisë dhe Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit për zhvillimin e Aksionit Kombëtar të Pastrimit "Të çlirojmë territorin nga ndotja mjedisore" që në Nëntor të 2021 ka filluar puna, është ngritur grupi i punës me **Urdhër nr. 78, datë 25.11.2021 "Për ngritjen e grupit të punës për çlirimin e territorit nga ndotja mjedisore dhe në kuadër të pastrimit dhe higjienizimit në Qarkun Durrës"**. Objekti i punës së këtij grupi ka qënëevidentimi, monitorimi, kontrolli dhe higjienizimi i zonave të ndotura.

Përgjatë vitit 2022 ndër aktivitetet më të rëndësishëm që kanë qënë në fokus të veprimtarisë së Institucionit të Prefektit në drejtim të mjedisit përmendim:

Më datë 14.01.2022 në Institucionin e Prefektit u zhvillua takimi me përfaqësues të huaj të Organizatës River Clean Up me qendër në Bruksel. Përfaqësuesit e kësaj organizate për Shqipërinë Z. Kevin De Backer, Z. Wannes Vercauteren dhe përfaqësues të kësaj organizate në Shqipëri Znj. Laura Gjyli, Elona Çausi dhe Genta Mesaja përfaqësuese e edukimit për shkollat dhe të rrjeteve sociale. Qëllimi i takimit ishte vendosja e urës së bashkëpunimit konkret në drejtim të pastrimit të lumit Ishëm nga ndotja si dhe edukimi dhe ndërgjegjësimi i shkollave, universitetit dhe komunitetit në çështjen e menaxhimit të mbetjeve. Në të njëjtën kohë u bë

prezantimi i nismës tashmë të ndërmarrë nga 15 shkolla në qytetin e Durrësit për mbledhjen dhe riciklimin e plastikës. Në takim u vlerësua kontributi dhe bashkëpunimi i deritanishëm me këtë organizatë në aksione të ndryshme të ndërmarra në pastrimin në derdhje të lumit Ishëm dhe pyllin në sektorin Rinia dhe në të njëjtën kohë u shpreh gadishmëria për bashkëpunim të mëtejshëm kryesisht në ndërgjegjësimin në drejtim të mos hedhjes së mbeturinave, prerjes së pemëve, ndotjes së ajrit, tokës dhe ujërave, ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit. Në takim përfaqësuesit e River Clean Up propozuan disa ide dhe teknologji për pastrimin e lumit Ishëm nga mbetjet të cilat janë të gatshëm ti implementojnë në këtë lum. Për këtë kërkohet një bashkëpunim konkret ndër-institucional për të cilin nga Institucioni i Prefektit u shpreh fryma e bashkëpunimit.

Më datë 15.01.2022 u zhvillua aksioni i pastrimit i 29-të nga River Clean Up Albania në Grykëderdhjen e Lumit Ishëm organizuar nga River-Cleanup.org Bruksel dhe dega e saj River Clean Up Albania. Në këtë aksion morën pjesë përfaqësues nga Institucioni i Prefektit të Qarkut të Durrësit, 40 punonjës nga Ndërmarrja Rruga dhe Pastrim Gjellbërimit, Bashkia Durrës, Agjencia e Zonave të Mbrojtura Durrës, 50 studentë të UAMD-së, 10 nxënës nga shkolla “Ibrahim Kodra”, gjimnazi “Gjergj Kastrioti”, shkolla 9-vjeçare “Vinçens Prendushi”, shkolla “Kushtrimi i Lirisë”, 5 mësues dhe pedagogë nga shkolla French International School of Tirana dhe UAMD-ja, 5 banorë të Ishmit përfshirë fëmijët, 5 aktivistë natyre nga Tirana e Durrësi, sikurse Alben Guide dhe alpinisti i thesareve shqiptare Fation Plaku, Si rezultat u mbledhën **4.4 ton (550 thasë) mbetje**, kryesisht plastikë nga **115 vullnetarë në 1000 m gjatësi lineare bregdet në 20 m gjerësi**.

Transportimi i mbetjeve do të bëhet nga bashkia Durrës, (duke shpresuar edhe njëherë të bëjmë riciklimin e shisheve plastike, kontenierëve të detergjentëve dhe atyre kozmetike si shampo etj, tapave plastike tek kompani private riciklimi), kurse ato të mbetjeve spitalore tek kompania private Eco Riciklimi.

Më datë 17.02.2022 Prefekti i Qarkut Durrës në kuadër të aksionit mbarë kombëtarë të pastrimit zhvilloi një takim me përfaqësues të Bashkive Durrës, Shijak dhe Krujë, Drejtuesve të Ndërmarrjes së Sh.K.Durrës, Drejtuesve të Ndërmarrjes së Sh.K.Plazh, mbi ecurinë e planit kombëtarë të pastrimit në Qarkun Durrës.

Në këtë takim Prefekti vlerësoi punën e bërë deri tani nga strukturat përgjegjëse të NjVV dhe kërkoi në të njëjtën kohë angazhimin maksimal në kontrollin e territorit, ndërhyrjen në pastrimin e hot-spotëve në territoret e tyre. Në të njëjtën kohë u kërkua bashkëpunimi i tyre me strukturat përgjegjëse (Policinë e Shtetit dhe Agjencia Rajonale e Mjedisit) në identifikimin dhe ndëshkimin e individëve dhe subjekteve të cilët ndotin mjedisin duke krijuar problematika në këtë drejtim.

Gjithashtu ai kërkoi të informohej në mënyrë periodike në lidhje me aksionet e pastrimit që ndërmeren nga këto njësi të vetqeverisjes vendore në kuadër të planit kombëtar të pastrimit por edhe të parapregatitjeve të sezonit të ri turistik 2022.

Disa nga problemet kryesore që u diskutuan janë:

1. Nga drejtori Sh.K.Plazh u ngrit përsëri problemi i një venddepozitimi për leshterikun dhe inertet e krijuara që akoma nuk është gati. Ai u shpreh se kemi një plan dhe jemi në bisedime

e sipër me bashkinë por që duhet të nxitojmë që të marrë zgjidhje sa më shpejt ky problem, për shkak se jemi në një situatë që presim një sasi të madhe leshteriku në këtë sezon si çdo vit tjetër.

2. Duhet t'i kushtohet një vëmendje maksimale rrugëve që të çojnë në plazh dhe në zonat turistike, mbi pastërtinë dhe kohën e caktuar që bizneset duhet të nxjerrin mbetjet e tyre për tu mbledhur nga ndërmarrjet e pastrimit.
3. Buxhetet e bashkive janë miratuar edhe përsa i takon menaxhimit të mbetjeve por problemi qëndron te mbledhja e të ardhurave dhe taksave në përqindjen e planifikuar. Duhet të jemi në kontakt me bashkitë për të patur parasysh një plan B që edhe nëse nuk mbledhen taksat në sasinë e duhur nuk duhet të përsëritet viti i kaluar.
4. Vazhdon hedhja e inerteve nga subjektet private në vende të paligjshme duke krijuar përsëri grumbullime mbetjesh edhe pse janë pastruar disa herë. Policia duhet të jetë e më vetëdijshme për të kontrolluar rrugët ku kalojnë këto mjete dhe të bëhet i mundur ndëshkimi i tyre.

Më datë 18.03.202 Prefekti i Qarkut Durrës zhvilloi një takim me Drejtorin e IVMT-së Durrës, Drejtorin e N.Sh.K.Durrës, Drejtorin e N.Sh.K.Plazh, Drejtorin e Ndërmarrjes Ura Ruga të Bashkisë Durrës dhe Drejtorin e Policisë Bashkiake në lidhje me aksionin 3-ditorë të pastrimit të territorit nga mbetjet urbane të qytetit. Prefekti caktoi datat 23,24,25 Mars si data kur do zhvillohen aksionet dhe u përcaktuan pikat kryesore ku do ndërhyet nga strukturat, mjetet dhe fuqia puntore e angazhuar nga këto struktura..

Bashkia Durrës do ndërhyjë në këto zona; segmenti rrugorë stacioni Iliria-St.Teuta Plazh, segmenti rrugorë stacioni Teuta-Hotel Vivas Plazh, kalaja e Ishmit, rreth rrotullimi i Shkozetit, rreth rrotullimi Ura e Dajlanit.

Bashkia Shijak do ndërhyjë në këto zona; rr. Hasan Vezi, kryqezim rr.Partizan- rr.Fadil Vezi, rr. Rexhep Keci , rr. Xhemal Deliallisi, digën e liqenit të Callikes(2 hotspote), rr.Gjepalaj 2-Hardhishtë (afër varrezave), kryqezim rr.Gjepalaj-Shahinaj, rr. Koxhas Fushë, rr. e varrezave Xhafzotaj, rr. kryesore Sallmone (1hotspot), rruga Baromet (2 hotspote) kryqezimi 4- rruget Xhafzotaj- fshati Pjeze (5 hotspote), rruga Nacionale Shijak- Durrës (3 hotspote), rruga Lilve, kryqezim i fshatit Vllazerim, rr. Panorama, rruga e fshatit Karpen, Rubjekë afër shkollës, rruga Maminas -Sukth (1 hotspot përballë biznesit Eco Pelet).

Bashkia Krujë do ndërhyjë në këto zona; në Njësinë Administrative Fushë-Krujë fshati Larushk pastrimi i lumit Zezë në dy anët e urës Larushk, në zonën e mbrojtur Krastë-Krujë hotspot i evidentuar afër aksit nacional Krujë-Fushë Krujë, në zonën e Fushë-Krujës te lagjia Magazine hotspot i evidentuar afër varrezave publike.

N.SH.K Plazh do të zhvillojë në ditët në vijim (të shtunë, të djelë, të hënë) një aksion pastrimi përgjatë vijës bregdetare dhe kryesisht Stacioni Iliria (ish blloku)-Stacioni Teuta dhe Stacioni Teuta-Vivas ku do të angazhohen 25 punonjës, 8 mjete (kamionë vetëshkarkues) dhe 2 fadroma

Gjatë diskutimit dolën disa problematika si psh; bizneset duhet të zbatojnë orarin e nxjerrjes së mbetjeve në koshat përkatës nga ora 22:00 deri në orën 6:00 të mëngjesit, jashtë këtij orari nuk duhet të ndodhë. Duhet një organizim më i mirë i forcave puntore, të cilët duhet të përqëndrohen aty ku ka më shumë nevojë për pastrim. Në kuadër të nismave dhe detyrës për të pasur një territor sa më të pastër është shtuar edhe një grafik pastrimi në drekë nga ana e ndërmarrjes së pastrimit të qytetit Durrës.

Më datë 22.04.2022 në kuadër të "**Ditës së Tokës**", janë realizuar disa aktivitete dhe aksione pastrimi në qark. Klubi i të rinjve në angazhimin komunitar në bashkëpunim me Bicycle Durrës dhe Bicycle Mayor këtë vit iu bashkua nismës "Dita e Tokës", për të nxitur qytetarët të përdorin mjetet e transportit alternativ për lëvizshmërinë në qytetin e Durrësit. Kjo iniciativë u zhvillua sidomos nga të rinjtë dhe qytetarë të qytetit të Durrësit ku nëpërmjet veprimit të tyre kërkojnë të dëgjohen përmes zgjedhjeve dhe veprimeve si qytetarë europian, në mënyrën se si ne marrim masa për klimën. Është koha për të ruajtur dhe mbrojtur shëndetin tonë, familjet tona, mjetet e jetesë së bashku, ne duhet të Investojmë në Planetin Tonë, ishte motoja e këtij viti. Mbledhja u bë në sheshin "Liria" në orën 16:00 për të biseduar me qytetarët për ndryshimet klimatike dhe pasojat në jetën tonë, për tu përgatitur më pas për aksionin e pedalimit i cili nisi në orën 18:00. Nisja u bë nga sheshi përpara teatrit "Aleksandër Moisiu" dhe vazhdoi në Bulevardin "Epidamn" – Currila vajtje/ardhje – Rruga "Egnatia" – Rruga "Hafiz Podgorica (lagja nr.4) – Bulevardi "Dyrrah" (kryqëzimi i "Valutës") – Pallati i Sportit – Rruga "Mujo Ulqinaku". Ky aktivitet u mbështet nga Qendra "DURRËSI AKTIV" në kuadër të projektit "Angazhimi i vullnetarëve të rinj në aktivizimin e komunitetit dhe reagimit ndaj fatkeqësive" si pjesë e programit të "Reagimit të Mbrojtjes Sociale ndaj Tërmeteve" (ESPR), një projekt i zbatuar i UNDP Albania dhe financuar nga Fondi i Përshejtimtimit të SDG: Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar, Qeveria e Finlandës dhe Qeveria e Holandës. Projekti mbështet Qeverinë Shqiptare dhe tre bashki të prekura nga tërmeti, në hartimin e politikës në veprime të duhura lokale për të siguruar që burrat, gratë, vajzat dhe djemtë që jetojnë në varfëri, ose situata të cënueshme, që ndërthuren me kushtet pas tërmetit, të kenë akses për shërbime sociale cilësore dhe të integruara.

Po në këtë ditë ZVA Durrës, Krujë dhe Shijak në bashkëpunim me shkollat kanë zhvilluar disa aktivitete të ndryshme kulturore-edukative, ku një prej tyre ishte edhe pastrimi dhe mbrojtja e mjedisit.

Në kuadër të angazhimit të shoqërisë civile në pastrimin dhe mbrojtjen e mjedisit, Organizata mjedisore "River Clean Up" ka organizuar aksione pastrimi me shkolla të ndryshme të qarkut Durrës nën nismën "Pastro lokalisht, festo globalisht". Pikërisht në 22 Prill, në kuadër të Ditës ndërkombëtare të Tokës por edhe në kuadër të pastrimit, edukimit dhe transformimit në shkollat 9-vjecare "Shaqe Mazreku", "Vinçenc Prendushi", "Bajram Curri", "Abedin Dino" Nxënësit dhe mësueset e shkollave 9-vjecare dhe kompania e gjelbër Middal me logot e tyre, kanë bërë të mundur që me riciklimin e plastikave të ndryshme të mbledhur nga nxënësit dhe mësuesit të mund të prodhohen kosha plastik funksional për mbetjet urbane. Gjatë këtij muaji nga kjo nisëm e ndërmarrë nga plastika e ricikluar janë realizuar deri më tani **7 kosha mbetjesh** dhe konkretisht

për këtë muaj: Koshi Numër 6 i ricikluar për komunitetin e zonave Informale të lumit Ishëm, dhuratë nga fëmijët e shkollave 9-vjeçare "Abedin Dino", "Bajram Curri", "Shaqe Mazreku" dhe kompania e gjelbër Middel me logot e tyre! Koshi Nr.7 i ricikluar për komunitetin e zonave Informale të lumit Ishëm, dhuratë nga fëmijët e shkollave 9-vjeçare "Vinçenc Prendushi", "Abedino Dino", "Bajram Curri", dhe kompania e gjelbër Middel me logot e tyre!

- **Më datë 14.05.2022** u zhvillua aksioni i pastrimit në grykëderdhjen e lumit Ishëm organizuar nga River Cleanup Albania. Në këtë aksion morën pjesë 210 vullnetarë; 55 gjimnazistë nga shkolla Ibrahim Kodra, 75 studentë nga UAMD dhe 20 studentë nga UT, 30 vullnetarë nga skuadra River-Cleanup.org dhe të rinj nga Erasmus Plus, aktivist natyre, 15 punonjës të pastrimit nga Bashkia Durrës, 5 nga Agjencia e Zonave të Mbrojtura Durrës, punonjës nga kompania Eco Riciklimi banorë të Ishmit, punonjës nga kompania Memory Plastik. Gjithashtu të pranishëm ishin edhe Nënkryetari i Bashkisë Durrës, Kryetari i Komunës së Ishmit, përfaqësues nga Prefektura Durrës, nga media reporterë nga ABC Neës. Si rezultat **u mblodhën 415 thasë, u pastruan 200 m linear vijë bregdetare** si dhe **u mblodhën 2 ton mbetje**. Në përfundim të aksionit u vlerësua me certifikatë nderimi për aksionet e Pastrimit të lumit Ishëm, themeluesi i River-Cleanup, Thomas de Groote, nga Kryetarja e Bashkisë Durrës.
- **Me datë 20.05.2022** u mbajt një takim në lidhje me aksionet e pastrimit që do të zhvillohen në javën e ardhshme në kuadër të planit kombëtar të pastrimit konkretisht në zonat bregdetare. Prefekti dhe Nënprefekti i Qarkut Durrës së bashku me sektorin e Zhvillimit Urban dhe Emergjencat Civile diskutuan në lidhje me organizimin e nismës dy ditore me qëllim që ky aksion të realizohet me sukses. Prefekti në bashkëpunim të ngushtë me Kryetaren e Bashkisë Durrës do ndjekin më nga afër aksionin ku mbështetja dhe bashkëpunimi do të jenë primare.
- **Më datë 24.05.2022 në kuadër të Planit Kombëtar të Pastrimit të nisur që në muajin Nëntor të vitit të shkuar e në vazhdim, u zhvillua një aksion i përqëndruar i pastrimit në zonën bregdetare.** Ky aksion vjen edhe në vazhdim të masave të marra në drejtim të fazës parapërgatitore për sezonin e ri turistik 2022, pra për të dhënë dorën e fundit pastrimit të zonave bregdetare.

Në këtë aksion mori pjesë Kryeministri Z.Edi Rama, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit Znj. Mirela Kumbaro, Ministri i Mbrojtjes Z. Niko Peleshi, Deputetët e Qarkut Durrës znj. Milva Ekonomi, Z. Jurgis Çyrbja, Kryetarja e Bashkisë Durrës Znj. Emiriana Sako, N/Prefekti i Krujës Z. Xhek Xheka, Drejtori i Agjensisë Kombëtare të Bregdetit Z.Ledion Lako.

Aksioni u përqëndrua në zonën bregdetare dhe pyjore të Gjirit të Lalëzit pranë Kompleksit San Pietro me një angazhim të plotë të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit; strukturave, forcave të armatosura pjesë e Ministrisë së Mbrojtjes; Prefekturës së Qarkut Durrës, Bashkisë Durrës; Agjensisë Kombëtare të Bregdetit; Administratës së Zonave të Mbrojtura; Ndërmarrjes Shërbimeve Komunale Durrës; Ndërmarrja Rruga; UKD.

Në këtë aksion **u angazhuan mbi 150 persona**, nga ku 50 ishin nga Forcat e Armatosura; u angazhuan 3 kamiona ushtrie, 1 buldozier ushtrie, 3 kamioncina, 1 fadromë, 1 autobot.

Forcat e angazhuara ishin të pajisura me mjete pastrimi (doreza, thasë mbetjesh, krehëra, lopata etj). Nga aksioni **u evaduan mbi 100 thasë mbetjesh**, si dhe **u hoqën rreth 30 Ton mbetje**.

Aksioni do të përqëndrohet në ditët në vazhdim edhe në grykëderdhjen e lumit të Ishmit, ku do të jenë të pranishëm edhe strukturat e Forcave të Armatosura me mjetet e tyre.

- **Më datë 25.05.2022** në kuadër të Planit Kombëtar të Pastrimit, u zhvillua dita e dytë e aksionit në grykëderdhjen e lumit Ishëm. **U angazhuan rreth 52 efektivë të Forcave të Armatosura** të pajisur me mjete pastrimi (doreza, thasë mbetjesh, krehëra, lopata), **si dhe 5 mjete**. Nga aksioni **u mblodhën rreth 620 thasë kryesisht plastikë**, pra **në total u hoqën rreth 6.5 Ton mbetje**.

Gjithashtu në po të njëjtën datë, Bashkia Durrës organizoi pastrimin e trotuarve dhe kunetave në rrugën “Aleksandër Goga” në segmentin Porto Romano – Fabrika e letres. Në këtë aksion **morën pjesë 30 punëtorë nga Ndërmarrja e Shërbimit Komunal Durrës dhe Ndërmarrja Rruga**, ku janë pastruar gjithsej **9000 m² trotuare**. Ky aksion do të shtrihet në gjithë rrugën “Aleksandër Goga”.

- **Me datë 26.05.2022** në kuadër të Planit Kombëtar të Pastrimit në Qarkun e Durrësit vazhdoi aksioni për pastrimin e territorit nga ndotja mjedisore. Në vazhdimësi të aksionit të datës 24 vijoi puna e përqëndruar në zonën bregdetare dhe hapësirat publike të Gjirit të Lalëzit pranë Kompleksit San Pietro. Në **aksion morën pjesë 54 efektivë Regjiment pjesë të Forcave të Armatosura**, të pajisur me mjete pastrimi (doreza, thasë mbetjesh, krehëra, lopata), si dhe **2 kamiona, 1 foristradë ushtrie dhe një fugon** për transportin e personave. Nga aksioni **u mblodhën 450 thasë me mbetje urbane**, pra **në total u hoqën rreth 2.5 Ton mbetje**.
- **Më datë 22.07.2022** u zhvillua një takim konsultues në lidhje me përgatitjen e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS) për Projektin e Portit të Ri Tregtar të Integruar të Durrësit në Porto Romano. Në këtë takim morën pjesë përfaqësues nga shoqëria Abkons Sh.p.k. të cilët bënë prezantimin e projektit të ndërtimit të Portit të Ri Tregtar të Integruar të Durrësit në Porto Romano dhe Prefekti bashkë me stafin tij. Ky takim kishte si qëllim të shkëmbejë informacione dhe njohuri mbi projektin dhe të ndërtojë marrëdhënie të forta afatgjata të bazuara në mirëkuptim, bashkëpunim dhe besim të ndërsjellë, me qëllim marrjen e komenteve dhe rekomandimeve nga palët e interesuara dhe ndikuara, përfshirë autoritetet qendrore, rajonale, lokale dhe komunitetet lokale, për të mundësuar një proces vendimmarrje të informuar. Kjo do të mundësojë një proces transparent dhe bashkëpunues. Angazhimi i palëve të interesuara do të vazhdojë gjatë gjithë procesit të VNMS-së dhe në fazat vijuese të projektit (ndërtimi dhe operimi) dhe përfshin tërë jetën e projektit

Më datë 29.08.2022 u morë pjesë në aksionin e pastrimit të realizuar nga River Cleanup Albania në Pyllin me Pisha dhe plazhin në Gjirin e Lalëzit, (pranë Drejtorisë së Policisë dhe Ambulancës). Në këtë aksion pastrimi **morën pjesë 50 vullnetarë**, nga të cilët: 26 gjimnazistë nga shkolla "Ibrahim Kodra" dhe studentë të UAMD-së, një mësuese e shkollës "Bajram Curri", e cila zgjodhi të bëjë mësimin në praktikë, një mësuese e gjuhës angleze me përvojë 5-vjeçare në Pekin, 4 fëmijë pushues në plazh, Administratori i Ishmit, 10 punonjës nga Agjencia e Zonave të Mbrojtura, 5

punonjës nga Drejtoria e Pastrimit, Bashkia Durrës me 1 makinë mbetjesh, 2 përfaqësues nga organizata Durrësi Aktiv. Si rezultat **u mbledhën 55 thasë** dhe mbetje të tjera që nuk futeshin në thes, prej 400 kg. Dominuan plastika dhe qelqi (shishe birre), duke pastruar **2000 m²**, të cilat u dërguan në Landfillin e Sharrës.

Më datë 07.12.2022 Prefekti i Qarkut me stafin tij morën pjesë në zhvillimin e dëgjësës publike organizuar nga Autoriteti Portual Durrës, mbi Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS) për Projektin e Portit të Ri Tregtar të Integruar të Durrësit në Porto Romano. Në këtë takim të pranishëm ishin: Drejtori të APD-së, Pirro Vengu, i cili bëri prezantimin e përgjithshëm të projektit të Portit të Ri Tregtar, inxhinierët teknikë të shoqërisë Abkons Sh.p.k. të cilët bënë prezantimin e (VNMS), përfaqësues nga Agjencia Shtetërore për Shpronësimet, përfaqësues nga institucionet vendore, Dhoma e Tregtisë, shoqëri tregtare, OJF, banorë të zonës përreth zonës ku do të kryhet ky investim, si dhe qytetarë të ndryshëm etj. Në këtë takim u diskutua rreth masave dhe praktikave më të mira që do të përfshihen dhe përshtaten në të gjitha fazat e projektit me qëllim mbrojtjen mjedisore gjatë fazës përgatitore të kantierit të ndërtimit, zbatimit të projektit dhe zhvillimit të operacioneve portuale me fokus kryesor uljen e ndotjes akustike dhe emetimeve në atmosferë, mbrojtjen e burimeve ujore dhe nëntokësore, ruajtjen dhe trajtimin e materialit të gërmuar, ruajtjen dhe menaxhimin e materialeve të ndërtimit, menaxhimin e mbetjeve, përmirësimin mjedisor ose rikthimin e hapësirave në gjendjen e tyre fillestare. Në këtë takim pati pyetje dhe diskutime të ndryshme në lidhje me zhvillimin e këtij investimi për të cilat u dhanë shpjegime nga specialistët përkatës.

Gjatë viti 2022 nga Institucionet në nivel qendror kanë dalë akte ligjore e nënligjore në drejtim të mbrojtjes së mjedisit për të cilat Institucioni i Prefektit është angazhuar në ndjekjen dhe zbatimin e tyre nga strukturat zbatuese përgjegjëse nëpërmjet koordinimi, bashkëpunimit dhe nxitjes së fushatave ndërgjegjëse në këtë drejtim.

Ndër aktet ligjore dhe nënligjore të dala për zbatim gjatë vitit 2022 përmendim dhe që kanë qënë në vëmendjen e Institucionit të Prefektit dhe Sektori i Zhvillimit Urban përmendim:

- Ligjin Nr. 28/2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar, ku nga data **1 qershor 2022 është ndaluar të përdoren**, tregëtimi, prodhimi dhe importimi i qeseve plastike njëpërdorimshe. Në të gjitha takimet e zhvilluara me fokus mbrojtjen e mjedisit jemi përpjekur të nënvizojmë rëndësinë e zbatimit të këtij ligji dhe janë lënë detyra konkrete për strukturat përgjegjëse për mbikqyrjen, sensibilizimin dhe ndërgjegjësimin e komunitetit dhe subjekteve për mospërdorimin e qeseve plastike njëpërdorimshe. Nga 1 korriku grupet inspektuese kanë nisur monitorimin e rreptë për zbatimin e këtij ligji. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit së bashku me kryetaren kanë inspektuar nga afër dyqane e supermarkete duke sensibilizuar përdorimin e trashave në vend të qeseve plastike. Përgjatë 6-mujorit të dytë të vitit 2022 vihet re një ndryshim drastik në përdorimin e qesës plastike një përdorimshe edhe pse ka ende vend për përmirësim.
- Udhëzimin Nr. 1, datë 24.03.2022 të Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, "Për nevoja të mbrojtjes së mjedisit, parandalimin e ndotjes në mjedis dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit, caktimin e ditës pa

makina", i cili përcakton si **ditë pa makina të dielën e parë të çdo muaji**, ka ndjekur dhe monitoruar ditët pa makina të organizuar nga Bashkitë Durrës, Shijak dhe Krujë. Kjo nismë synon ndërgjegjësimin e qytetarëve së pari për një mjedis më të pastër nga CO₂, si dhe për të promovuar përdorimin e mjeteve alternative të transportit jo vetëm për mbrojtjen e mjedisit por dhe për të kursyer karburantin.

Në drejtim të zbatimit të këtij udhëzimi nga Institucioni i Prefektit është kujtuar dhe kërkuar në mënyrë të vazhdueshme nga Bashkitë e qarkut, zbatimi i këtij udhëzimi si një ndër format e rëndësishme në edukimin dhe mbrojtjen e mjedisit. Gjatë kësaj periudhe Prill-Dhjetor 2022 mund të themi që nga Bashkia Durrës ka patur një korrektësi në zbatimin dhe implementimin e "Ditës pa makina" ku në të djelën e parë të muajit në një orar të caktuar blokohej kalimi i mjeteve në një orar të caktuar. Ndërsa nga Bashkia Shijak dhe Krujë jo gjithmonë është implementuar kjo nisëm, kjo edhe për faktin që janë bashki të vogla cilat kanë të limituar rrugët (kryesore) për qarkullimin e mjeteve. gjithësesi mendoj që përgjatë vitit 2023 nga Institucioni i Prefektit do të nxiten këto bashki edhe më tepër për implementimin dhe zbatimin e këtij udhëzimi, kjo edhe si një formë edukimi dhe respektimi të mjedisit ku jetojmë.

- Në zbatim të nismës së Kryeministrit të Shqipërisë dhe Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit për zhvillimin e **Aksionit Kombëtar të Pastrimit "Të çlirojmë territorin nga ndotja mjedisore"** Institucioni i Prefektit përgjatë vitit 2022 ka zhvilluar takime të vazhdueshme me të gjithë strukturat të cilat janë pjesë e grupeve të punës, për të koordinuar dhe bashkërenduar punën si dhe për tu informuar në mënyrë periodike në lidhje me ecurinë e punës në drejtim të mbrojtjes mjedisore.

Referuar raportimeve mujore nga Janari në Dhjetor, në qarkun Durrës janë ndërmarrë aksione të shumta në drejtin të pastrimit të territorit, ku janë angazhuar strukturat e Njësive të Vetqeverisjes Vendore, Degët territoriale, Institucionet Shtetërore në nivël vendor, Institucionet Arsimore, organizata të ndryshme, firma riciklimi, kontribues të tjerë.

Përmbledhja e të gjithë aksioneve të pastrimit të kryer në qarkun Durrës për periudhën Janar-Dhjetorë 2022 paraqitet në tabelën më poshtë:

BASHKIA	SASIA E MBETJEVE TË PASTRUARA (ton)	NUMRI I FORCAVE TË ANGAZHUARA	NR. MJETEVE TË PËRDORURA	NR. I HOTSPOTEVE TË PASTRUARA
Durrës	5720.7	1953	5 kamionë +1 fadromë + 6 kamioncina +1 foristradë ushtrie + 1 autobot	77
Shijak	1124.3	1177	2 kamionë + 1 kamioncine+1 fadromë	137
Krujë	2321	910	1 fadromë + 2 kamionë	67

			+ 1 kamioncin + 1 kamion vetëshkarkues + 1 kamioncinë vetëshkarkuese	
QARKU	9166	4040	24	281

Gjatë këtij viti janë organizuar aksione pastrimi edhe nga Institucione të tjera ku në total kanë marrë pjesë 1907 persona. Konkretisht:

BASHKIA DURRËS: Janë organizuar 6 (gjashtë) aksione ku në aksione të caktuara kanë marrë pjesë gjithë administrata e bashkisë dhe institucione të tjera qendrore në nivel vendor, të gjitha shkollat nën juridiksionin e ZVAP Durrës, organizata River CleanUp, Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë. **Në total në të gjitha këto aksione janë angazhuar rreth 1314 persona.**

BASHKIA SHIJAK: Është organizuar 1 (një) aksione ku kanë marrë pjesë gjithë administrata e bashkisë dhe të gjitha shkollat nën juridiksionin e ZVAP Shijak. **Në aksion janë angazhuar rreth 315 persona.**

BASHKIA KRUIJË: Janë organizuar shtatë aksione ku në aksione të caktuara janë përfshirë administrata e bashkisë, organizata River CleanUp, stafi i aeroportit, ADZM Durrës, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ambasadoret e Gjermanisë, Francës, Greqisë, Sllovenisë, Spanjës, Hollandës, përfaqësues nga Ambasada Italiane. **Në këto aksione janë angazhuar në total 313 persona.**

Ashtu sikurse vihet re përgjatë vitit 2022 ka patur një angazhim nga të gjitha strukturat përgjegjëse në nivel qarku të cilat kanë kontribuar në pastrimin e territorit dhe heqjen e mbetjeve të akumuluar për vite me rradhë në zona të caktuara të territoreve të bashkive. Ky aksion padyshim që ka dhënë impaktin e tij edhe pse ka ende shumë për të bërë në këtë drejtim. Ky Aksion mbarë komëtarë do të zhvillohet edhe përgjatë vitit 2023 në territorin e qarkut Durrës në mënyrë që të mundësojmë pastrimin dhe higjienizimin edhe më tej të territorit. Megjithatë gjykojmë dhe mendojmë që përveç aksioneve të implemendohen edhe forma të tjera edukimi dhe ndërgjegjësimi në ndrejtim të mbrojtjes së mjedisit nga hedhja e mbetjeve në mënyrë të paligjshme. mendokmë dhe gjykojmë që duhet të angazhohen edhe struktura të tjera ligjzbatuese në identifikimin dhe ndëshkimin e atyre individëve apo subjekteve që ndosin ambjentin në mënyrë të paligjshme dhe padyshim që kjo gjë do të jetë prioritet i punës së Institucionit të Prefektit dhe të gjithë strukturave përgjegjëse.

Problematikat kryesore në drejtim të mbrojtjes së Mjedisit të evidentuara gjatë vitit 2022 në drejtim të mbetjeve

1. Mungesa e një venddopozitimi për leshterikun dhe inertet (Bashkia Durrës, Shijak, Krujë)
2. Hedhja e inerteve nga individë apo subjektet private në vende të paligjshme
3. Moszbatimi nga disa biznese të orarit të nxjerrjes së mbetjeve në koshat përkatës nga ora 22:00 deri në orën 06:00 të mëngjesit sidomos gjatë periudhës së sezonit turistik veror (bashkia Durrës)

4. Ndotja e vazhdueshme e zonave të nxehta mjedisore të cilat pasi pastrohen, për një kohë shumë të shkurtër rimbushen me mbetje nga vetë qytetarët. Veçanërisht ngelen problematike zonat periferike të Bashkive Durrës, Krujë dhe Shijak ku largësia dhe terreni i vështirë në zonat rurale e bën të vështirë kontrollin dhe ndërhyrjen nga ana e shërbimeve të pastrimit.
5. Mbeten problematike shkarkimet e mbetjeve urbane, në brigjet e lumit Erzen dhe Ishëm të cilat prurje e lumenjëve i depozitojnë në grykderdhjen e lumenjëve për ti derdhur më pas në det apo zonat bregdetare përreth tyre.

Objektivat e punës tonë për vitin 2023 në drejtim të mbrojtjes së mjedisit në drejtim të mbetjeve dhe në tërësi

Institucioni i Prefektit dhe Sektori i Zhvillimit Urban do të organizoj punën e tij dhe do të koordinoj të gjithë strukturat përgjegjëse në drejtim të mbrojtjes mjedisore në këto drejtime:

- Vazhdimi i Planit Kombëtar të Pastrimit “Të çlirojmë territorin nga ndotja mjedisore”, si dhe organizimi i aksioneve të ndryshme pastrimi në bashkëpunim me strukturat dhe institucionet vendore në qark.
- Realizimi i fushatave sensibilizuese për angazhimin dhe edukimin e brezit të ri si dhe ndërgjegjësimin e njerëzve për mbrojtjen e mjedisit, ruajtjen dhe përmirësimin e tij.
- Vëmendje të theksuar do të ketë zbatimin e Planit Lokal të Menaxhimit të Mbetjeve brenda territorit të rajonit dhe forcimi i bashkëpunimit midis autoriteteve të pushtetit vendor, qendror dhe sektorit privat.
- Mbrojtja dhe mirëmbajtja e parqeve, lulishteve, hapsirave të gjelbërta, monumenteve të kulturës dhe pasurive natyrore.
- Monitorimi i masave që do ndërmerren për përmbushjen e standarteve mjedisore dhe administrimin e qëndrueshëm të zhurmave nga institucionet përgjegjëse.
- Rritjen e bashkëpunimit me Policinë e Shtetit për evindentimin e rasteve dhe shkeljeve që bëhen në rastet e ndotjes mjedisore, hedhjeve të mbetjeve në vende të jashtëligjshme.
- Do të kushtohet një vëmendje maksimale pastrimit të rrugëve që të çojnë në zonën bregdetare apo në zonat turistike.
- Puna jonë do të orientohet dhe në drejtim të rivitalizimit (mbjellja e pemëve). Duhet të jetë në vëmendje të njëjësive të vetqeverisjes vendore, shtimi i hapësirave të gjerbëra në zona dëmtuara, në rrugë të ndryshme të qyteteve, pranë zonave të banuara, apo në vende që nuk ka fare bimësi.

❖ ZONAT E MBROJTURA MJEDISORE

Sektori i Zhvillimit Urban gjatë viti 2022 ka patur në vëmendje të punës së tij në bashkëpunim edhe me Administratën e Zonave të Mbrojtura Mjedisore për qarkun Durrës, zonat e mbrojtura mjedisore. Vëmendja e punës ka qënë në drejtim të monitorimit të vazhdueshëm për mbrojtjen e ZM-ve dhe parandalimin e aktiviteteve të paligjshme në ZM, në mënyrë të veçantë në drejtim të mbrojtjes së tyre nga ndërtimet pa leje; në lidhje me shfrytëzimin e gurores nga shoqëritë e shfrytëzimit të tyre; mbrojtjen nga zjarri, apo edhe pyllëzimit të zonave të mbrojtura.

Nisur nga këto aspekte në rolin edhe të drejtuesit të Komitetit të Zonave të Mbrojtura, Institucioni i Prefektit ka zhvilluar takime të ndryshme me strukturat përgjegjëse, ka patur korenspondenca të ndryshme në lidhje me koordinimin e punës dhe veprimin në zbatim të ligjit në këto zona.

Ndër takimet më të rëndësishme të zhvilluara përgjatë viti 2022 përmendim:

- **Takimin e datës 30.05.2022** në mbledhjen e rradhës të Komitetit të Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura Mjedisore drejtuar nga Prefekti i Qarkut Tiranë z.Afrim Qëndro në cilësinë e kryetarit të Komitetit të Zonave të Mbrojtura për Qarkun Tiranë. Të pranishëm ishin përfaqësues të administratës së zonave të mbrojtura të Qarkut Tiranë dhe Qarkut Durrës, përfaqësues të OSHEE, ZVA - Tiranë si dhe të UNDP. Çështjet kryesore që u diskutuan gjatë mbledhjes ishin analiza e punës ndërmjet dy mbledhjeve të Komitetit të Menaxhimit dhe masat e marra për parandalimin dhe përballimin e situatës së zjarreve si veprim kryesor për ruajtjen nga dëmtimi i pariparueshëm të kësaj zone. Gjithashtu u bë prezantimi i rezultateve të Projektit “Mbi forcimin e qëndrueshmërisë financiare të Zonave të Mbrojtura” mbështetur nga UNDP Albania. Problematikat kryesore që u evidentuan dhe detyrat e lëna gjatë kësaj mbledhjeje ishin:
 - Mungesa e një plani menaxhimi për Zonën e Mbrojtur të Dajtit,
 - mungesa e një stacion pompimi/furnizimi me ujë në Dajt, stacion i cili duhet të realizohet me patjetër,
 - Realizimi i një plani pune /grafiku për trajnimin e punonjësve të Zonave të Mbrojtura për fikjen e zjarrit në momentet e para të rënies së tij kur është e mundur apo për parandalimin e përhapjes së mëtejshme deri sa të mbërrijnë zjarrfikset,
 - Pastrimi i shtigjeve në terren për të lehtësuar ardhjen e zjarrfikësve pranë pikave ku ka rënë zjarr, Organizim i takimeve nga njësitë administrative me punonjësit e bizneseve përreth zonës së mbrojtur për ti sensibilizuar/qartësuar mbi detyrimin ligjor që kanë për të marrë masat e para me mjetet bazike (të siguruara nga biznesi) për shuarjen apo parandalimin e përhapjes së zjarrit.
 - Përsa i përket projektit të UNDP-së, ky projekt ka për qëllim forcimin e kapaciteteve të AKZM për një planifikim, administrim dhe menaxhim të burimeve financiare të ZM; si dhe zbatimin e mekanizmave të përshtatshëm për përmisimin e të ardhurave në zona të mbrojtura të veçanta. Në këtë takim, u theksua rëndësia e angazhimit dhe bashkëpunimit maksimal të të gjitha strukturave përgjegjëse me qëllim mbrojtjen dhe rritjen e vlerave të këtyre zonave të mbrojtura.
- **Takimi i datës 23.06.2022**, ku Prefekti i Qarkut nën cilësinë e kryetarit, zhvilloi mbledhja e rradhës së Komitetit të Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura Mjedisore. Të pranishëm ishin anëtarë të Komitetit të Menaxhimit dhe Zv/drejtori e Zëdhënësja e Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës. Si fillim ADZM-ja bëri një pasqyrë të sipërfaqeve aktuale të Zonave të Mbrojtura të Qarkut Durrës si dhe një përmbledhje të punës së bërë gjatë këtij viti, për të vazhduar më pas me analizën e objektivave kryesore për ruajtjen e këtyre zonave. Çështjet kryesore që u diskutuan gjatë kësaj mbledhjeje ishin:

Çështjet kryesore që u diskutuan ishin:

- *Aktivitetet e paligjshme (guroret; furrat e gëlqeres) në zonën Krastë – Verjon*

- Zjarret në Zonat e Mbrojtura Mjedisore , menaxhimi i tyre në kohë
- Gjuetia e paligjshme në këto zona
- Monumentet e kulturës, mbrojtja dhe mirëmbajtja e tyre
- Ndërtimet pa leje në ZMM Krastë Verjon dhe Parkun Natyrorë Qafë Shtamë
- Infrastruktura rrugore që të çon në këto zona

Për të gjitha problematikat e ngritura u lanë detyra konkrete për strukturat përgjegjëse në mënyrë që të marrin rrugën e zgjidhjes

Përgjatë vitit 2022 Sekroi i Zhvillimit Urban ka patur takime si dhe ka marrë informacione të vazhdueshme periodike nga Administrata e Zonave të Mbrojtura Durrës mbi veprimtarinë e punës së saj, problematikat që kanë hasur si dhe zgjidhja e tyre.

Gjatë vitit 2022 në Zonat e Mbrojtura Mjedisore kemi këto të dhëna statistikore:

Në drejtim të rivitalizimit të ZMM janë mbjellë **rreth 2500 fidane**, kryesisht në Parkun Natyror Qafështamë, Parkun Kombëtarë Dajt dhe në shkolla të ndryshme të qarkut. **Janë kryer 25 aksione pastrimi** ku janë angazhuar **2500 persona**, nxenës, studentë, organizata River Clean Up, bashkia Durrës dhe Krujë.

Ka patur **4 raste zjarresh**, 2 në PM Krast-Verion dhe 2 në Qafështamë.

Numri i vizitorëve janë 254 950 vendas dhe 29 750 të huaj.

Problematikat dhe çështjet kryesore të Zonave të Mbrojtura të evidentuara gjatë vitit 2022

1. Monitorimi nga strukturat përgjegjëse të vazhdimit të aktiviteteve të paligjshme (guroret) në zonën e Krujës
2. Monitorimi dhe ndërhyrja e strukturave përgjegjëse mbi ndërtimet pa leje në zonat e mbrojtura mjedisore
3. Problem mbi rehabilitimin e hektarëve të djegur, hapjen e rrugëkalimeve të automjeteve të zjarrfikëses apo dhe krijimin e stacioneve të zjarrfikëses pranë këtyre zonave të mbrojtura.
4. Mungesa e pajisjeve dhe mjeteve të ndërhyrjes së shpejtë që AdZM duhet të kenë për shuarjen e zjarreve.
5. Furnizimi me ujë – mungesa e hidrantëve në këto zona të mbrojtura mjedisore në mënyrë që të mund të ndërhyet në kohë në rastë zjarri
6. Problem mbetet rruga e Qafështamës si një rrugë tej e amortizuar
7. Ndotja e mjedisit, e ujrave, mbetjet urbane e rurale dhe hedhja e inerteve në ZM kjo më e theksuar në PM “Krastë-Vrion”.
8. Erozioni tokësor, dhe prurjet e larta të sedimenteve, të theksura në Parkun Kombëtarë Qafë-Shtamë. Gjithashtu, për shkak të reshjeve, erozioni në basenin e Bovillës paraqet një rrezik serioz për fshatin Bruz Mal dhe Bruz Zall në një sipërfaqe prej rreth 300 ha, duke rrezikuar banesat, tokën bujqësore dhe infrastrukturën në zonë dhe ndotjen e liqenit Bovillë.
9. Prerja sporadike e pyejeve, kryesisht për dru zjarri, marrja e gjethit, dëmtime nga kullotja, zvogëlimi i sipërfaqes dhe dëmtim i monumenteve të natyrës nga faktorë natyrorë dhe jo vetëm.

Objektivat e punës tonë për vitin 2023 në drejtim të Zonave të Mbrojtura Mjedisore

1. Ndjekja në mënyrë të vazhdueshme; të zbatimit të planit të pastrimit në ZMM, të mbrojtjes dhe mirëmbajtjes së parqeve dhe pasurive natyrore.
2. Shtimi i vëmendjes në drejtim të monitorimit të vazhdueshëm nga strukturat përgjegjëse për prani të gurave aktiv, furrave të gelqeres, ndërtimeve pa leje, si dhe nxitja e zhvendosjes së tyre nga ajo zonë për ta rehabilituar atë.
3. Ndërgjegjësimi i komunitetit në dhënien e informacionit por dhe nëse ka një rast sporadik ndërhyrja për eliminimin e këtij zjarri që mos të marrë përmasa më të mëdha.
4. Krijimin e kushteve për; rritjen e sasisë së mbjelljeve të pemëve të reja, hapjen e shtigjeve të tjera turistike, rehabilitimin e infrastrukturës si dhe të mbrojtjes së faunës dhe florës.

INVESTIMET

Është ndjekur mbarëvatja e investimeve të ndryshme që kanë të bëjnë me zhvillimin ekonomiko-social dhe urban në qarkun tonë. Në qarkun tonë po bëhen investime strategjike shumë të rëndësishme jo vetëm për qytetin e Durrësit por për të gjithë Shqipërinë. Investimet më të rëndësishme mund të përmendim, Porti i Ri Tregtar në Porto Romano, Porti Turistik i Durrësit, Hekurudha Tiranë-Durrës dhe Lungomare e Re e Plazhit të Durrësit. Këto investime do të kenë impakt pozitiv në zhvillim ekonomik të vendit, me ndikim të drejtpërdrejtë në punësim, në zhvillimin afatgjatë me rëndësi kombëtare e rajonale, do të ketë përmirësimin e imazhit të vendit, si mikpritës i investitorëve të huaj dhe si garantues i tyre. Gjithashtu pritet përmirësimi i infrastrukturës dhe faciliteteve urbane, për forcimin e komunitetit, ofrimin e shërbimeve sociale, zhvillimin e artit dhe kulturës, si dhe të zhvillimit të mëtejshëm të sektorit të turizmit në tërësi.

Gjatë vitit 2022 në monitorim të Prefektit të Qarkut kanë qënë këto investime strategjike:

- **Porti i Ri Tregtar në Porto Romano** është një nga investimet më të rëndësishme dhe strategjike në qark, ku ka përfunduar hartimi i projektit dhe pritet të hidhet në garë ndërkombëtare në Janar, për të nisur më pas me çeljen e kantierit të punimeve brenda vitit 2023.
Një vepër me rëndësi kombëtare në funksion të tregut të përbashkët rajonal, projekti i Portit të ri Tregtar të Durrësit, ndër të tjera, integron hekurudhën Durrës – Prishtinë dhe Portet e thata në Kosovë e Maqedoni të Veriut”.
Porto-Romano do të ketë një sipërfaqe prej 400 hektarë me kapacitet prej 2 milionë kontejnerë deri në 50 milionë tonelata. Po ashtu parashikohet të presë deri në 1 milion pasagjerë. Nëpërmjet këtij projekti distanca me Prishtinën pritet të shkurtohet në 265 kilometra.
Projekti i investimit në Porto Romano, në përfundim të tij përlllogaritet të ketë një impakt pozitiv në GDP e Shqipërisë nga 3 % deri në 6 %.
Sa i përket afateve kohore pritet që:
 - Deri në fillim të vitit 2026 do të përfundojnë dhe do të vihen në punë Vendbregëzimet e përgjithshme të ngarkesave.
 - Terminali i kontejnerëve do të përfundojë dhe do të vihet në funksion deri në fillim të vitit 2026. Lidhja hekurudhore me portin e ri do të përfundojnë deri në fillim të vitit 2030.

- Deri në vitin 2060 mund të jenë të nevojshëm tre Vendbregëzime, pasi mund të konstatohet që dy Vendbregëzime nuk do të jenë të mjaftueshme për të përballuar fluksin e parashikuar deri në vitin 2055.
- **Projekti i Marinës Turistike të Durrësit** ku në nëntor të 2020, në Emiratet Bashkuara Arabe, u nënshkua një marrëveshje me princin e kurorës për ta kthyer portin e Durrësit nga një port mallrash tërësisht të dedikuar turizmit. Parashikohet ndërtimi i një porti marinë, me jahte, hotele, qendra tregtare dhe ambiente argëtuese. Projekti parashikon që porti Durrësit të jetë 2 herë më i madh sa ai Tivarit në Malin e Zi. Jahtet e ankoruara do të jenë të gjatësisë nga 15 deri 200 metra. 1.264.552 m² është hapësira dedikuar 12.000 njësive të banimit për 46.000 rezidencë. Mbi 47.000 janë planifikuar për shërbime ku përfshihen mbi 170 dyqane ndërsa 47.000 m² të tjerë, për ndërtim hotelesh. Zona e gjelbër do të ketë rreth 80.000 pemë. Në qendër të portit është parashikuar ndërtimi një hoteli shumëkatës, i ngjashëm me kullë-gërvishtësit e Dubait. Ky Investim prej 2 miliardë eurosh në portin e ri të Durrësit pritet të përfundojë në vitin 2026
- **Hekurudha Tiranë-Durrës** është një tjetër investim që parashikon jo vetëm ndërtimin e një linje të re për në Aeroportin Ndërkombëtar “Nënë Tereza”, por edhe modernizimin e linjës ekzistuese Tiranë-Durrës nëpërmjet përmirësimit të karakteristikave gjeometrike dhe operacionale të vijës hekurudhore në përputhje me standardet e BE-së. Ky projekt fillon në platformën e stacionit të Terminalit të Durrësit dhe përfundon pranë ish-stacionit të Trenit në Tiranë me një gjatësi totale prej mbi 35km, ku konkretisht do të realizohet rehabilitimi i 34.7 km dhe ndërtim të linjës 5.7 km. Gjithësej kostoja totale e projektit është 92.1 milionë euro, nga të cilat 35.5 milionë euro grant mbulohet nga Kuadri i Investimeve i Ballkanit Perëndimor (EBIF) dhe 36.9 milionë euro është i mbuluar nga kredia e BERZH, ndërsa pjesa e mbetur do financohet nga qeveria shqiptare. Më datë 03.02.2021 u nënshkrua kontrata e projektit kur dhe nisën punimet të cilat priten të përfundojnë rreth fillimit të vitit 2024.
- Më 26 Tetor 2022 ka nisur puna për ndërtimin e **Lungomares së Durrësit** që shtrihet përgjatë plazhit të vjetër të Durrësit nga rezidenat qeveritare dhe përfundon tek ura e Dajlanit. Ky projekt do të kushtojë 3 milion dollarë dhe është financim i qeverisë shqiptare. Faza e parë e projektit nga kavalishenca deri tek pista Kosova, pritet të mbyllet në Maj të vitit 2023, ndërsa faza e dytë do të vijojë nga Pista Kosova deri tek Ura e Dajlanit. Gjatë gjithë gjatësisë do të ketë seksion 6 deri në 10 metra. Seksioni nga 6-10 metra të vijës së shëtitorës do të trajtohet më një plan, përveç lëvizshmërisë do të ketë pistë për vrap dhe bicikleta, ndricim, pemë, dhe elementë të tjerë si rekracion, ndërrim të mjeteve të sportit në det dhe hapësira për fëmijët. Përpos shëtitorës me pistë vrapimi dhe korsi për biçikleta, do të ndërhyhet gjithashtu dhe për zgjerimin e brezit të rërës. Gjithashtu me përfundimin e Lungomares do të kërkohen financime të tjera për rikonstruksonin e fasadave të pallateve dhe hoteleve përgjatë vijës së parë. Padyshim që ky investim infrastrukturor do të ndikoj në zhvillimin dhe përmirësimin e cilësisë së turizmit në zonën bregdetare.

II. Drejtimi i Task Forcave Vendore, krijimi i organizmave të përkohshëm, të komiteteve të grupeve të punës dhe të komisioneve për çeshtje të caktuara:

Task Forca Vendore Antikanabis

Gjatë vitit 2022, në territorin e Qarkut Durrës dinamika e kriminalitetit me tendencë kultivimin e bimëve narkotike paraqitet si më poshtë :

Janë evidentuar 57 raste të kultivimit të bimeve narkotike gjate kontrollit te ushtruar ne Njesitë Administrative Nikël, Cudhi, Fushë Krujë, Ishëm, Xhafzotaj, Shijak, Bubq, Durrës dhe Manëz ne fshatrat Fushë Krujë, Kuraten, Zgërdhesh, Larushk, Zallë, Kurcaj, Sallmone, Shqezë, Bruz Mal, Barkanesh, Droje Mukje Rranxë Mafsheq, Brret, Boville, Rinas, Shetaj, Bize, Shkafane, Lalez, Likmetaj. Larushk, Drrac, Kroi I madh, Cudhi Kamp, Noj, Kameras, Zezë, Borianë, Zallë, Virjon dhe Arameras, Zezë, Borianë, bruz Zalle, Mazhe e vogel, Cudhi kant, Picrrage, Bilaj Bubq, Vadardhe, Bura, Halilaj, Bruz- Mal, Virjon dhe Arameras dhe Kodër Laç, Thumane, Borizane, noje, Mallkuç, Rrotull, Grize, Kurcaj, Derven, Picerrage, Dukagjin i Ri, lagjja Boje, Shkozë e Bardhë dhe Luz **zbuluar 30.**

Janë evidentuar 57 vepra penale për kultivim të bimëve narkotike, zbuluar 30, me autor 53, nga të cilët 19 janë arrestuar, 1 ndaluar, 18 ndiqen në gjendje të lirë dhe 16 janë shpallur në kërkim.

Gjithashtu, janë **referuar materialet për 4 persona** me detyrë punonjës të OSHEE-së Durrës, dhe dy punonjës të sektorit pyjor. për veprën penale “Shpërdorim detyre” të parashikuar nga neni 248 I K. penal, nga të cilët arrestuar 2 ndaluar 0, ndjekur në gjendje të lire 2 shpallur në kërkim 0.

Janë gjetur/asgjësuar 471 ambjente nga 462 ambjente të hapura dhe 9 ambjente të mbyllura me 10675 bimë narkotike, nga të cilat 843 fidanë në kubikë, 9619 të mbjella në tokë dhe në vazo 208 , 0 bime te mbira vetë , 28.550 kilogram, në gjendje të thatë e dyshuar kanabis sativa dhe 3.36 gr lëndë narkotike kanabis sativa, ne forme boce.

Komiteti Rajonal Antitrafik

KRAT Durrës hartoi Planin e Veprimit për vitin 2022 i cili u miratua në takimin e parë të këtij viti nga Kryetari i KRAT njëkohësisht dhe prefekti i qarkut. Në këtë plan përfshihen organizimi dhe ndërmarrja e fushatave masive ndërgjegjësuere në nivel lokal për informimin lidhur me format e trafikimit dhe efektin e tij në jetën e individit dhe shoqërisë, përfshirë ndërgjegjësimin për të drejtat e VT/VMT gjatë gjithë vitit, veçanërisht gjatë muajit tetor, nëpërmjet formave të komunikimit si:

Spote ndërgjegjësuere mbi fenomenin e trafikimit të qenieve njerëzore në radio&televizione lokale. Fushatë ndërgjegjësimi në terren dhe online nëpërmjet faqes së mediave sociale në lidhje me mënyrat e shfrytëzimit dhe format e shfaqjes së trafikimit, përfshirë format e trafikimit online. Materiale ndërgjegjësuere të printuara që synojnë grupet vulnerabël, djemtë, vajzat e gratë, fëmijët, komunitetin rom dhe egjiptian, në zonat urbane dhe rurale, rritjen e mundësive sociale dhe ekonomike për personat që i përkasin grupeve vulnerabël nëpërmjet masave efektive integruere në kuadër të zbatimit të dokumenteve për integrimin e romëve dhe egjiptianëve. mbrojtjen e fëmijëve

nga shfrytëzimi ekonomik, përfshirë fëmijët në situatë rruge.strategjinë për zhvillimin e arsimit parauniversitar dhe strategjinë kombëtare për punësim dhe aftësi. strategjinë e strehimit social që synojnë arsimimin, punësimin dhe përfshirjen sociale.Qëllimi i këtij plani është informimi dhe sensibilizimi për rrezikun e trafikimit të personave, prandaj puna jonë është përqëndruar kryesisht në aktivitetet informuese,sensibilizuese të zhvilluara gjatë gjithë vitit por me intensitet më të lartë në muajin antitrafik. KRAT Durrës vetëm gjatë muajit tetor antitrafik, ka zhvilluar rreth 30 aktivite të ndryshme informuese dhe sensibilizuese, ku të gjitha strukturat e TryezesTeknike u angazhuan dhe shpërndanë fletëpalosje, video informuese, mesazhe sensibilizuese për fenomenin e trafikimit.Numri i viktimave të trafikimit për vitin 2022 ishte 9 nga të cilat 4 të rritur dhe 5 fëmijë.Sipas procedurave përkatëse 7 viktimave janë rikthyer në familje ndërsa 2 janë sistemuar në qendrat e pritjes.

Task- Forca Vendore “Për Monitorimin dhe Kontrollin e Masave për Zbatimin e Detyrimeve Ligjore si dhe sigurinë në Plazhe përgjatë Sezonit Turistik Veror 2022”

Për mbarëvajtjen e sezonit Turistik u ngritën dy grupe pune përkatësisht:

1. Grupi i parë i Task-Forcës përgjatë gjithë sezonit turistik ka monitoruar dhe marrë masa në drejtim të zbatimit të VKM-së Nr.321 datë 28.05.2014 “Për sigurinë në det, plazhe, në ujrat e brendshme në thellësi të territorit dhe gjatë ushtrimit të sporteve ujore” dhe të VKM-së nr. 171, datë 27.03.20199 Për miratimin e rregullores “Per kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”.
2. Grupi i dytë i Task-Forcës ka kryer kontroll përgjatë vijës bregdetare, e përbërë nga Institucioni Prefektit të Qarkut Durrës, Inspektoriati Shtetëror Shëndetësor, Njësia Vendore e Kujdesit Sëndetësor (Higjena) dhe Shërbimi i Mbrojtjes ndaj Zjarrit. U kontrolluan të gjitha sipërmarrjet e shërbimit ushqimor (restorante, lokale bar kafe).

Me datë 03 qershor 2022, në sektorin përgjatë vijës bregdetare nga Ura Dailanit deri te Përroi Agait, u krye kontroll ndaj subjekteve të pajisura me leje nga Bashkia Durrës për ndërtimin dhe funksionimin e vendbazimeve me korridor për hyrje – dalje të mjeteve lundruese me motorr dhe atyre argëtuese motorrë uji, në zbatim të detyrimeve të përcaktuara në VKM Nr.321, datë 28.05.2014 “Për sigurinë në det, plazhe, në ujërat e brendshme, në thellësi të territorit dhe gjatë ushtrimit të sporteve ujore.” Ky kontroll u krye nga Policia Kufitare, Kapiteneria Durrës dhe Drejtoria e Urbanistikës në Bashkinë Durrës, si pjesë përbërëse e grupit të Task-Forcës për Turizmin ngritur me Urdhër të Prefektit të Qarkut Durrës, e cila vijon si më poshtë:

Në zonën e plazhit përballë Hotel “Giardino” nga subjekti “Zuna W” sh.p.k. është ndërtuar vendbazimi me korridor hyrje-dalje për mjetet lundruese motor uji, i paisur me dokumentacionin përkatës të lëshuar nga Bashkia Durrës. Korridori i hyrje-daljeve të motorrave të ujit ishte i kufizuar me bova që galixhojnë, përgjatë gjatësisë rreth 300 m duke filluar nga bregu, me hapje në të dy anët e tij. Në vendbazim ndodheshin 3 mjete lundruese, motorra uji, të cilat ishin të paisur me dokumentacionin e duhur.

Në zonën e Plazhit të Madh Durrës, në anë të Hotel “Canal Grande” ndodhej i ndërtuar vendbazimi me korridor hyrje-dalje për mjete lundruese, motor uji, në pronësi të personit fizik Skerdilaid Xhameta i paisur me dokumentacionin përkatës të lëshuar nga Bashkia Durrës. Në vendbazim ndodheshin, 4 motorra uji. Mjetet ishin të paisur me dokumentacionin e duhur. Koridori i hyrje-daljeve të motorrave të ujit ishte i kufizuar me bova që galixhojnë, përgjatë gjatësisë rreth 300 m duke filluar nga bregu, me hapje në të dy anët e tij.

Në zonën e Shkëmbit të Kavajës, përballë Hotel “Pampas” është ndërtuar vendbazimi me korridor hyrje-dalje për mjete lundruese, motor uji, në pronësi të personit fizik Skerdilaid Xhameta i paisur me dokumentacionin përkatës të lëshuar nga Bashkia Durrës. Në vendbazim ndodheshin, 4 motorra uji. Mjetet ishin të paisur me dokumentacionin e duhur. Koridori i hyrje-daljeve të motorrave të ujit ishte i kufizuar me bova që galixhojnë, përgjatë gjatësisë rreth 300 m duke filluar nga bregu, me hapje në të dy anët e tij.

Në vendbazime gjenden dhe paisje të vrojtimit dhe kontrollit në distancë (dylbi) si dhe dispononte (pult komandimi) fikje në distancë të motorëve për garantim të lundrimit të sigurtë të tyre gjatë përdorimit. Mjetet ishin të kompletuar me jelekë shpëtimi, gjithashtu ishin vendosur tabelat shpjeguese në gjuhë shqip dhe anglisht me rregullat mbi përdorimin e mjeteve lundruese në këtë vendbazim si dhe tabela treguese si zonë e kryerjes së sporteve ujore.

Në përfundim të kontrollit, subjektet u këshilluan për mbajtjen gjithmonë të kompletuar me paisjet e duhura, korridorin e përdorimit të mjeteve lundruese, drejtuesit e vendbazimeve para dhënies në përdorim të motorrave të detit, duhet të informojë përdoruesin, mbi mënyrën e përdorimit të mjetit dhe rregullat që duhen zbatuar në lundrim.

Nga përdoruesit e mjeteve të zbatohen me korrektësi kushtet e lundrimit të sigurtë; shpejtësia 3 nyje gjatë daljes dhe hyrjes në koridor, respektimi i distancave të nevojshme të përcaktuara; 100m nga notuesit, 50m nga motorrat e tjerë, 200m nga anijet e ankoruara, gjatë përdorimit të motorrave të detit, asnjëherë më e vogël se 300m nga bregu i detit, distanca më e largët e lundrimit deri në 1 milje nga bregu.

Më datë 14 korrik në plazhin e quajtur Sektor Rinia u shënua një ngjarje tragjike, ku 18-vjeçari Anri Kashiku nga Durrësi humbi jetën ndërsa u fut të ndihmonte të vëllain e mitur, i cili bashkë me një shok tjetër të mitur ishin futur në detin e trazuar me dallgë dhe nuk po arrinin të dilnin.

Më datë 16 gusht 2022 në Institucionin e Prefektit të Qarkut Durrës u zhvillua takimi i rradhës me anëtarët e Task-Forcës Vendore të sezonit turistik 2022. Takimi u drejtua nga Prefekti i Qarkut Durrës z. Emiljan Jani, ku të pranishëm ishin: Drejtoria Vendore e Policisë së Shtetit, Drejtoria Vendore e Kufirit dhe Migracionit, Bashkia Durrës, Kapiteneria e Portit Detar dhe Agjencia Kombëtare e Bregdetit. Në mbledhje u diskutua për situatën aktuale të vendbazimeve, që gjenden në vijën bregdetare të Qarkut Durrës, ku secili institucion raportoi mbi gjëndjen aktuale të vendbazimeve dhe se si mund të rifillojnë aktivitetin e tyre pas pezullimit të përkohshëm për motive të sigurisë, respektimit me rreptësi të kriterëve të përshkruara në ligj dhe shërbimit të sigurtë ndaj pushuesve. Të gjitha institucionet pjesëmarrëse në takim vendosën që të nesërmen e datës 17 gusht 2022 të kryejnë një kontroll në të gjitha vendbazimet aktive në vijën bregdetare të Qarkut Durrës. Kontrolli kishte për qëllim zbatimin e të gjitha kriterëve të parashikuara në ligjin për turizmin, në të kundërt këto sipërmarrje nuk do të mund të rifillonin aktivitetin e tyre pa plotësimin e të gjitha standarteve të sigurisë së kërkuar.

HYRJE-DALJE NË PORTIN E DURRËSIT: Vetëm gjatë sezonit turistik veror 2023 janë regjistruar të dhënat si më poshtë: ➤ Hyrje shtetas të juaj: 120139 persona; ➤ Dalje shtetas të huaj: 134457 persona; ➤ Hyrje shtetas shqiptar: 125839 persona; ➤ Dalje shtetas shqiptar: 121551 persona; Në tëtrësi: 502166 persona.

III. Marrëdhëniet e Prefektit me Organet e Vetëqeverisjes Vendore.

Në mbështetje të ligjit 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, gjatë vitit 2022 në Institucionin e Prefektit kanë hyrë gjithsej 356 akte të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore (Këshilli i Qarkut Durrës, Bashkia Durrës, Krujë dhe Shijak), nga të cilat: Të bazuara në ligj janë 286 akte, të pa bazuara 8 akte dhe me karakter individual 62 akte.

Gjatë vitit 2022 për Këshillin e Qarkut janë vlerësuar 7 akte me karakter individual.

Gjatë vitit 2022 për Bashkinë Durrës janë vlerësuar 32 akte me karakter individual

Gjatë vitit 2022 për Bashkinë Krujë janë vlerësuar 10 akte me karakter individual

Gjatë vitit 2022 për Bashkinë Shijak janë vlerësuar 13 akte me karakter individual

Gjithsej 62 akte me karakter individual.

a) Verifikimi në vend i ligjshmërisë së akteve

Në zbatim të nenit 17 të po këtij ligji, institucioni i Prefektit ka verifikuar ligjshmërinë e akteve me karakter normativ drejtpërdrejtë dhe sistematikisht në të tre Bashkitë e Qarkut dhe Këshillin e Qarkut Durrës, çdo tre muaj.

Gjatë këtyre verifikimeve në vend të ligjshmërisë, nuk janë konstatuar akte normative të padepozituara tek Prefekti sipas procedurës së parashikuar në nenin 16 të këtij ligji, si rrjedhojë nuk kemi patur rastet e këkesave për pavlefshmëri akti në Gjykatë.

Gjatë këtyre kontrolleve dhe në vazhdimësi gjatë punës tonë u kemi lënë organeve të vetëqeverisjes vendore rekomandimet tona me shkrim në lidhje me vazhdimësinë e punës së Këshillave Bashkiakë. Disa nga rekomandimet janë si vijon:

Nevoja e rishikimit të rregullores së funksionimit të këtyre këshillave në mënyrë që çdo pikë e kësaj rregulloreje të mund të gjejë zbatim konkret nga këshilli gjatë punës së tij, rekomandim ky i nxitur edhe nga problematikat e lindura gjatë vijueshmërisë së punës së këshillave bashkiakë.

Gjithashtu në vijim të korespondencës sonë zyrtare edhe të më hershme kemi rekomanduar paraqitjen për verifikim të ligjshmërisë së akteve pranë Prefektit të Qarkut të cilat duhet të plotësojnë kriteret që ka një akt nënligjor me karakter normativ në zbatim të nenit 8/a të Ligjit nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” si dhe nenit 16 të këtij ligji. Aktet me karakter individual të miratuara nga Këshilli Bashkiak apo nga Bashkia hyjnë në fuqi në datën e njoftimit të tyre subjekteve që përfshihen në to (neni 55/6 i ligjit 139/2015), datë e cila duhet të shënohet në dispozitivin e vendimit si dhe nuk është e nevojshme të depozitohen tek prefekti i qarkut për verifikim ligjshmërie. Kjo bën të mundur edhe mos zvarritjen e individëve të cilëve u drejtohet ky akt, të cilët nuk ka arsyetim ligjor të presin afatin dhjetë ditor të verifikimit të ligjshmërisë nga Prefekti.

Gjithashtu kemi rekomanduar duke e parë të domosdoshëm dhe një objektiv thelbësor të punës në vijim të prefektit, respektimin e kreut VI të ligjit për vetëqeverisjen vendore mbi transparencën, konsultimin dhe pjesëmarrjen qytetare në çdo lloj vendim marrje ku pjesëmarrja e komunitetit është kërkesë ligjore.

RINDËRTIMI

Gjatë këtij viti një vëmendje e veçantë ka patur dhe procesi i rindërtimit si edhe problematikat e dala nga tërmeti i 26 Nëntorit 2019. Vëmendja e punës së Prefektit të Qarkut ka qënë kryesisht në drejtim të ndjekjes dhe monitorimit të punës në zonat për rindërtim në të tre bashkitë, ndjekjes së punës nga strukturat përgjegjëse të rforcimit të pallateve të dëmtuara, rikonstruksionit të banesave individuale si dhe në dhënien e granteve dhe dëmshpërblimeve për të gjithë banorët përfitues për kategoritë DS1,DS2 dhe DS3.

I është kushtuar vëmendje ankesave/kërkesave të paraqitura nga qytetarët në lidhje me problematikat që ata kanë patur në procesin e post tërmetit dhe atij të rindërtimit. Për të gjitha këto problematika Institucioni i Prefektit i është drejtuar në kohë institucioneve kompetente për dhënie zgjidhje të tyre. Është bërë kontrolli i bazueshmërisë ligjore të vendimeve të ardhura nga Këshillat Bashkiak të Njësive të Vetqeverisjes Vendore Durrës, Krujë, Shijak në lidhje me të gjithë procedurat e ndjekura për procesin e post tërmetit.

Gjatë gjithë periudhës Janar - Dhjetor 2022 në të tre bashkitë e qarkut ka vazhduar ndërtimit i zonave të reja të banuara të cilat janë;

Në bashkinë Durrës: Zona 4 Spitallë, Zona 1 Nj. Ad. Manëz, Fshati Lalëz Nj. Ad. Ishëm;

Në bashkinë Shijak: është Zona 1;

Në bashkinë Krujë janë, Zona 1 Nj. Ad. Bubq, Zona 1 Nj. Ad. Thumanë, Zona 1 Nj. Ad Fushë-Krujë dhe Zona 1 bashkia Krujë.

Nga Institucioni i Prefektit janë marrë në shqyrtim bazueshmërie ligjore vendimarrjet e Këshillave bashkiak të të tre bashkive në lidhje me këtë proces.

Në mënyrë të veçantë Prefekti i Qarkut ka ndjekur dhe monitoruar procesin e hedhjes së shortit për banorët përfitues në zonën e Manzës, të cilët u vendosen në **226 apartamente të reja të ndërtuara në 9 pallate.**

Në zonën e Spitallës gjatë viti 2022 është punuar për ndërtimin në total **të 996 apartamente**, kantieri më i madh i rindërtimit në vend, ku ka nisur ndërtimi i lotit të parë të 15 pallateve të para me 156 hyrje, që do të jenë gati në muajt e parë të vitit 2023.

Në **zonën e Ishmit** gjatë viti 2022 ka vazhduar dhe vazhdon ende **ndërtimi i 300 banesave të reja individuale.**

Në bashkinë e Shijakut ka përfunduar procesi i rindërtimit të **31 pallateve me 665 apartamente**, ku është ndjekur edhe **hedhja e shortit për 802 familje** të cilët kanë siguruar një apartament.

Në bashkinë e Krujës ka përfunduar rindërtimi në Njësinë Administrative Bupq ku janë sistemuar në apartamentet e tyre **120 familje**. Po ashtu edhe në Njësinë Administrative Thumanë ka përfunduar **ndërtimi i 14 pallateve**, 278 apartamenteve dhe **155 banesave individuale**. Në zonën e Fush-Krujës **ka përfunduar ndërtimi i 15 pallateve** me 100 apartamente si dhe **167 shtëpi individuale.**

Në qytetin e Krujës **vazhdon procesi i rindërtimit të 684 banesave**, nga këta 242 apartamente brenda zonave të rindërtimit dhe 96 apartamente në jashtë tyre.

Përveç rindërtimit të pallateve dhe banesave të reja vëmendja e Institucionit të Prefektit ka qenë edhe në monitorimin e ridërtimit të; shkollave dhe kopshteve, qendrave shëndetësore, banesave individuale, godinave social - kulturore dhe zonave sportive.

IV. Për raportime të veçanta.

Viti 2022 ka qenë një vit i vështirë sfidash, përpjekjesh, realizimeve të detyrave por edhe problematikave të ndryshme të ndeshura në punën tonë, kjo edhe si rezultat i periudhës së post tërmetit por edhe pandemisë së shkaktuar nga COVID-19. Pavarësisht vështirësive dhe problematikave të ndryshme gjatë vitit 2022 jemi përpjekur që të realizojmë objektivat tona të caktuara që në fillim të vitit me profesionalizëm dhe përkushtim .

Më datë 31 janar 2022 Institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës ndëmoni një kontroll në terren për zbatimin e protokolleve kundër Covid-19 të lëshuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Arsimit dhe Sporteve, ku u vu re respektimi me përpikmëri I të gjitha elementeve të sigurisë, duke theksuar mbajtjen e distancës me nxënësve, trupës pedagogjike, vendosja në të gjitha klasat e dezinfektuesve për duart dhe mbajtja e maskave gjatë gjithë procesit mësimor.

Më datë 25 shkurt 2022 Institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës mori pjesë në Analizën Vjetore 2021 të DRAP (Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar) Durrës, që u mbajt në mjediset e shkollës 9-vjeçare “Vinçenc Prendushi” në Durrës, me pjesëmarrjen e 12 drejtorëve të ZVA-ve të të tria qarqeve që kjo drejtori ka nën juridiksionin e saj. Gjatë analizës vjetore u evidentua i gjithë procesi i punës së këtij institucioni të rëndësishëm, duke shtjelluar çështje të ndryshme si:

Rekrutimi i mësuesve të rinj në portalin qeveritar Mësues për Shqipërinë;

Cilësia dhe arritjet e mësuesve të rinj për marrjen e lishencës pas praktikës 1-vjeçare në institucionet e arsimit parauniversitar në Qarkun Durrës, ku për vitin e lënë pas ishte me notën mesatare 6.7 dhe me një kalueshmëri prej 55%;

Procesi i rindërtimit të shkollave tashmë të rindërtuara dhe atyre në process ndërtimi;

Sistemi i ngrohjes në të gjitha institucionet e arsimit parauniversitar të porsa ndërtuara dhe përmirësimi i këtij sistemi në shkollat e tjera ekzistuese në Qarkun Durrës;

Shtimi i oficerëve të sigurisë, psikologëve, mësuesve ndihmës dhe punonjësve social në të gjitha institucionet e arsimit parauniversitar, duke rritur njëherazi sigurinë, mbarvajtjen dhe cilësinë në të gjitha këto institucione.

Respektimi me përpikmëri i protokolleve të lëshuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrisë së Arsimit kundër COVID-19, ku nuk kanë munguara maskat mbrojtëse, dezinfektuesit për çdo klasë, në hyrje të institucioneve arsimore parauniversitare dhe ruajtja e distancës;

Me datë 16 mars 2022 në mjediset e Institucionit të Prefektit të Qarkut Durrës u mbajt takimi sensibilizues kundër kultivimit dhe përdorimit të kanabisit, me drejtorët e shkollave të Rrethit Durrës. Në këtë takim u diskutuan disa çështje tepër tërëndësishme për sensibilizimin e të rinjve kundër përdorimit të bimëve narkotike, kjo si një detyrë e ngarkuar drejtorëve të shkollave për të

sensibilizuar nxënësit e tyre kundrejt kësaj problematike, e cila në të vërtetë prek të gjithë shoqërinë tonë. Përpos kanabisit gjatë takimit u diskutua edhe Plani Kombëtar i Pastrimit të territorit, ku drejtorëve të shkollave iu kërkua gjithashtu kontributi i tyre për të sensibilizuar nxënësit për të mbajtur pastër mjediset e shkollave të tyre, por edhe më gjërë në komunitetin ku jetojnë. Ndër të tjera sipas kërkesës dërguar ZVA-ve Durrës, Krujë dhe Shijak nga ana e Institucionit të Prefektit, këto tre ZVA i janë përgjigjur pozitivisht i orientuar mësuesit e tyre që kanë klasa kujdestari për të vazhduar me pastrimin e territorit dhe mjediseve të përbashkta, ku klasat nga e I tek e V janë këshilluar të angazhohen me pastrimin e klasës së tyre, koridoreve, lulet dhe të gjithë territorim por brenda oborrit të shkollës dhe së bashku me prindërit e tyre dhe mësuesin kujdestarë në krye. Klasat nga e VI tek e IX janë këshilluar të angazhohen për pastrimin e rrugicave dhe shesheve përreth shkollave të tyre në lagje sëbashku me prindërit e tyre dhe me në krye mësuesin kujdestarë. Ndërsa shkollat e mesme janë orientuar në hapsira të ndryshme publike të qytetit të paracaktuara nga organizatorët lokal të aktivitetit dhe mësuesit kujdestarë që do të jenë në krye dhe përgjegjës për mbarëvajtjen e aktivitetit për klasën e tyre.

Me datë 23 mars 2022 Institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës mori pjesë në Analizën Vjetore të ZVA (Zyrës Vendore Arsimore) Durrës, ku përpos saj u diskutuan një mori çështjesh të ndryshme, duke filluar nga përgatitja për provimet e Maturës Shtetërore dhe provimet e Lirimit për vitin shkollor 2021-2022. Ndër të tjera u shtruan dhe pyetje të cilat kishin të bënin me dallim e arritjeve në të nxënë dhe rezultate e nxënësve midis shkollave publike dhe atyre jo publike, metodologjia e ndjekur nga trupa pedagogjike për t'i përcjell njohuritë e reja sa më mirë tek nxënësit e tyre. U diskutua gjithashtu edhe disiplina e nxënësve në mjediset e institucioneve të arsimit parauniversitar, që ka të bëjë me etikën e komunikimit, përgatitjen sistematike, respektimi i rregullave, orës së mbërritjes në mëngjes dhe ndërveprimi mes shokët dhe shoqet e klasës. Padyshim mes të tjerave u evidentuan disa problematika, që kishin të bënin me mospërputhshmëria e arritjeve për disa nxënës për sa i përket rezultateve të deklaruara nga shkollat dhe ato të deklaruara nga ZVA Durrës. Një tjetër problematikë ishte edhe mangësia e plotësimit me personel pedagogjik në disa shkolla, process, i cili lidhet drejtpërdrejt me atë të Mësues për Shqipërinë. Pagesa e kontributi të prindërve ishte një tjetër çështje e ngritur nga disa drejtorë shkollash të cilët hodhën mendime, që ky kontribut duhet paguar çdo fillim viti shkollor. Në vazhden e problematikave ishte edhe vështirësia e përfutimit të njohurive të reja nga nxënësit përgjatë tre vieve të fundit si pasojë e pandemisë COVID-19, ku procesi mësimor është zhvilluar në pjesën më të madhe online. Drejtoritë e shkollave shprehën shqetësimin e tyre për mungesën e fotokopjeve dhe mjeteve të tjera për mbarëvajtjen e procesit mësimor.

Më datë 22 prill 2022 u organizua në të gjithë shkollat e sistemit parauniversitar nën juridiksionin e Prefekturës së Qarkut Durrës, festa e Ditës së Tokës, ku shumë prej këtyre institucioneve arsimore kanë realizuar aktivitete të larmishme në këtë drejtim. Të tre ZVA-t e Prefekturës së Qarkut Durrës; ZVA Durrës, ZVA Krujë dhe ZVA Shijak kanë raportuar se në institucionet arsimore parauniversitare nën juridiksionin e tyre janë mbajtur shfaqe artistike, recituar poezi dhe hapur ekspozita me punimet e nxënësve të cilët kanë patur si tematikë krijuese Ditën e Tokës. I gjithë ky organizim në kuadër të Ditës së Tokës, e cila është një ngjarje vjetore, që festohet në të gjithë botën

më 22 prill për të demonstruar mbështetjen për mbrojtjen e mjedisit, shkollat e rrethit të Durrësit dhe Krujës kanë organizuar së bashku me nxënësit aktivitete të ndryshme ndërgjegjëse. Dita e Tokës për herë të parë është festuar në vitin 1970, ndërsa tani përfshin ngjarje të koordinuara globalisht nga Rrjeti i Ditës së Tokës. Qëllimi kryesor i aktiviteteve që realizohen në këtë ditë është jo vetëm ndërgjegjësimi ndaj ndryshimeve klimatike, por edhe për ta mbrojtuar atë. Dita e Tokës është një reflektim se si mund të bëjmë të mundur që ajri që thithim dhe uji që pijmë, apo mjedisi ku jetojmë të jetë i pastër dhe i shëndetshëm për të gjithë ne. Ndaj në Ditën e Tokës nxënësit e të tre ZVA-ve janë përkushtuar të evidentojnë nëpërmjet punimeve të tyre artistike problematikat, që shqetesojnë sot botën rreth mbrojtjes së mjedisit, natyrës dhe biodiversitetit të saj dhe shfrytëzimit të burimeve natyrore.

Më datë 27.04.2022 kemi marrë pjesë në trajnimin e zhvilluar nga Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD) në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe mjedisit me temë “Plani i masave dhe organizimi i grupeve të punës në terren, për reagimin ndaj ndotjes detare shkalla I dhe shkalla II, vlerësimi i derdhjes, si dhe impakti i ndotjes në shëndetin publik”. Në këtë trajnim morën pjesë specialistë të fushave të ndryshme që kanë të bëjnë me organizimin e operacioneve të reagimit ndaj ndotjeve detare dhe janë pjesë e Planit për Reagimim të Prefekturës dhe konkretisht përfaqësues nga: Drejtoria Rajonale e Policisë Kufirit dhe Migracionit, Inspektorë të Drejtorisë Rajonale të Mjedisit, Kapiteneria e Porteve (për territorin e zonës bregdetare Durrës), Autoriteti Portual Durrës si dhe Drejtoria e Mjedisit të Portit, specialistë nga Porti i Hidrokarbureve, Porti i Porto Romanos, Inspektorë për çështjet mjedisore pranë Drejtorisë Rajonale të Njësisë së Kujdesit Shëndetësor, përfaqësues nga Bashkia Durrës. Ky trajnim kishte si qëllim njohjen me planin e masave të Qendrës Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD) e cila ka detyrë; organizimin, planëzimin dhe drejtimin e operacioneve detare në të gjithë hapësirën detare, bashkërendimin e punës në operacionet e kërkim – shpëtimit, si dhe parandalimin dhe mbrojtjen e mjedisit detar nga ndotja. Gjithashtu u kërkua bashkëpunimi me të gjitha institucionet përgjegjëse nëpërmjet bashkërendimit të të gjitha burimeve të disponueshme, si mjete detare, ajrore e tokësore, sistemet, personelin etj.

Në përfundim të këtij trajnimi u arrit në këto përfundime; **a)** Është e nevojshme të bëhet ratifikimi i konventave dhe protokolleve të nevojshme ndërkombëtare dhe Rajonale. **b)** Rezulton i nevojshëm dhe emergjent plotësimi dhe përditësimi i Planit Kombëtar të Emergjencave si dhe domosdoshmëria e pasjes së një grupi të gatshëm vullnetar. **c)** Rekomandohet që Republika e Shqipërisë të bëjë përpjekje që të bëhet pjesë e Marrëveshjes Nën-Rajonale të Detit Adriatik së bashku me Italinë, Kroacinë dhe Slloveninë. **d)** Është e nevojshme të bëhet në mënyrë të vazhdueshme trajnimi i personelit si një element thelbësor i efektivitetit të operacioneve reaguese. **e)** Është i nevojshëm që institucionet dhe kompanitë private të shtojnë kapacitetet me pajisje reaguese antindotëse.

Me datë 10 maj 2022 Prefekti i Qarkut Durrës zhvilloi një takim me të gjithë aktorët përgjegjës për sa i përket situatës së rrugëve kombëtare dhe rurale në qarkun Durrës. Të pranishëm ishin: Drejtori i Drejtorisë së Rajonit Qëndror Tiranë pranë ARRSH, Shefi i Sektorit të Policisë Rrugore pranë

Policisë Vendore Durrës, Drejtori i Policisë Bashkiake, Nën/Kryetari i Bashkisë Durrës, Drejtori i Shërbimeve dhe Investimeve Publike dhe Drejtori i Rrugëve Rurale Krujë, Drejtori i Ndërmarrjes së Shërbimeve Komunale Durrës, Drejtori i Ndërmarrjes Rruga, Drejtori Rajonal i IKMT-së. Gjatë këtij takimi u diskutuan një sërë problematikash që kanë të bëjnë kryesisht me rrugët në qarkun e Durrësit, mirëmbajtja dhe siguria në akset rrugore, problematikat, pikat e nxehta dhe përmirësimi i sinjalistikës horizontale dhe vertikale. Ndër të tjera u diskutuan masat e marra dhe që do të merren në vazhdimësi në kuadër të parapërgatitjes për sezonin e ri turistik 2022, sidomos në rrugët që të çojnë në zonat turistike (investimet, mirëmbajtja, sinjalistika, ndërhyrje, problematikat që paraqiten në to). Në mbyllje të takimit, Prefekti i Qarkut theksoi rëndësinë e bashkëpunimit dhe kërkoi që të merren të gjitha masat e domosdoshme për të siguruar mbarëvajtjen sa më të mirë të sezonit turistik.

Me datë 18 maj 2022 u mbajt mbledhja e Komitetit Rajonal të Zhvillimit të Turizmit, ku pjesëmarrës ishin disa prej institucioneve si pjesë përbërëse e këtij komiteti në nivel qarku. Në këtë takim ishin të pranishëm: Nën/Kryetari i Bashkisë Durrës, Drejtori i Autoritetit Portual Durrës, Drejtues të Degëve Territoriale të Qarkut, Drejtues të Organeve të Vetëqeverisjes Vendore, Kryetari i Shoqatës së Turizmit Ata Horeca dhe Operatorë Turistik. Gjatë mbledhjes u diskutua për përcaktimin e objektivave dhe mënyrave për promovimin e turizmit në qark, ngritja e task-forcave për menaxhimin dhe mbarëvajtjen e sezonit turistik veror si dhe marrjen e masave për mirëmbajtjen e rrugëve drejt destinacioneve turistike. Ndër të tjera Prefekti kërkoi angazhim të plotë nga çdo institucion në zbatimin e planit të masave si dhe bashkëpunimin e tyre me organet e rendit për marrjen e masave efektive për sigurinë publike gjatë gjithë sezonit turistik.

Me datë 19 maj 2022 morëm pjesë në hapjen e aktivitetit kulturor, pjesë e projektit me temë: “Forcimi i Qytetarisë Demokratike”, organizuar nga shkolla 9-vjeçare “Hamza Muça” në bashkëpunim me Keshillin e Evropës, Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Qendra Kulturore Durrës dhe Ministria e Arsimit të Turqisë. Ky aktivitet kishte për qëllim shkëmbimin ndërkulturor midis nxënësve të shkollës “Hamza Muça” dhe 12 shkollave të ndryshme 9-vjeçare nga Turqia. Aktiviteti falë poezive të recituara, këngëve, valleve, mbjelljes së pemëve dhe lojrave sportive shpërfaqti elementët më të mirë kulturore nga të dyja vendet, duke vlerësuar me çmime disa prej nxënësve për arritjet e tyre.

Me datë 20 maj 2022 u zhvillua Konferenca Shkencore Ndërkombëtare me temë: “Siguria në Ballkanin Perëndimor”, me ftesë të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës në bashkëpunim me Universitetin Cote D’Azur të Francës, e cila u mbajt në mjediset e Fakultetit të Shkencave Politike Juridike, pranë kampusit Universitar 2 Spitalë. Përpos konferencës dy universitetet nënshkruan edhe një marrëveshje bashkëpunimi për njohjen e diplomës së dyfishtë në programin e studimit të ciklit të dytë, Master i Shkencave në Administrimin Publik. Konferenca bëri bashkë profesorë, akademikë dhe hulumtues shkencor të cilët shkëmbyen mes tyre studime, gjetje kërkimore shkencore dhe përvojat e tyre rreth aspekteve të ndryshme për sa i përket Sigurisë në Ballkanin Perëndimor.

Më datë 09 qershor 2022 u zhvillua provimi i parë i Maturës Shtetërore për vitin shkollor 2020-2021. Procesi i provimit u zhvillua normalisht nën monitorimin e përfaqësuesve të Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sporteve dhe Zyra e Vendeve Arsimore (ZVA) përkatëse. Gjatë procesit të provimit u zbatuan të gjitha rregullat e protokollit të përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; si distancimi fizik dhe përdorimi i masave mbrojtëse.

Më datë 11 qershor 2022 u zhvillua provimi i dytë i Maturës Shtetërore për vitin shkollor 2021-2022. Procesi i provimit u zhvillua normalisht nën monitorimin e përfaqësuesve të Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sporteve dhe Zyra e Vendeve Arsimore (ZVA) përkatëse. Gjatë procesit të provimit u zbatuan të gjitha rregullat e protokollit të përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; si distancimi fizik dhe përdorimi i masave mbrojtëse.

Më datë 17.06.2022 në Institucionin e Prefektit të Qarkut Durrës u zhvillua takimi me Kryetaren e Bashkisë Ogródzieniec të Polonisë znj. Anna Pilarczyk nën drejtimin e Prefektit z. Emiljan Jani dhe Drejtoresha për Çështjet Vendeve dhe Prefekturat në Ministrinë e Brendshme znj. Alma Mele.

Gjithashtu ishin të pranishëm: Konsulli i Nderit të Ukrainës në Shqipëri z. Bledi Bajraktari, Presidentja e operatorit turistik Polak, Rego-Bis znj. Gabriela Mańka – Sokullu, Drejtuesja e kompanisë Aler Travel znj. Tetiana Bajraktari të cilët ishin iniciues kryesor të nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit midis dy palëve, Partneri Shqiptar i Rego-Bis, Kryetarë të disa Bashkive në Poloni, biznesmenë, këshilltarë dhe zyrtarë të tjerë të pushtetit vendor në disa qytete polake. Nga Prefekti u bë një panoramë e përgjithshme për ecurinë e zhvillimit ekonomik, kulturor dhe historik të Qarkut Durrës duke i falenderuar që vijnë dhe frekuentojnë qytetin e Durrësit.

Kryetarja e Bashkisë Ogródzieniec të Polonisë znj. Anna Pilarczyk vlerësoi në mënyrë të veçantë mikpritjen dhe bujarinë ku shprehu falenderime si dhe vlerësoi zhvillimin që ka pësuar turizmi në këto vite. Në fund të takimit u nënshkrua një Memorandum Mirëkuptimi për Miqësi dhe Bashkëpunim midis Komunës së Ogródzieniec, Republika e Polonisë dhe Prefektit të Qarkut Durrës, Republika e Shqipërisë.

Gjatë muajit Qershor në qendër të vëmendjes ka qenë ndjekja dhe sensibilizimi mbi ligjin Nr. 28/2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar. Nga data 1 qershor 2022 është ndaluar të përdoren, tregëtimi, prodhimi dhe importimi i qeseve plastike njëpërdorimshe. Duke filluar nga 1 Korriku do të ketë masa ndëshkuese ndaj subjekteve që prodhojnë, tregëtojnë por edhe nga përdoruesit e tyre.

Më datë 20 qershor 2022 u zhvillua provimi i Lirimit për klasat e nënta për vitin shkollor 2021-2022. Procesi i provimit u zhvillua normalisht nën monitorimin e përfaqësuesve të Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sporteve dhe Zyra e Vendeve Arsimore (ZVA) përkatëse. Gjatë procesit të provimit u zbatuan të gjitha rregullat e protokollit të përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; si distancimi fizik dhe përdorimi i masave mbrojtëse.

Më datë 20 qershor 2022 u zhvillua provimi i Lirimit për klasat e nënta për vitin shkollor 2021-2022. Procesi i provimit u zhvillua normalisht nën monitorimin e përfaqësuesve të Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sporteve dhe Zyra e Vendeve Arsimore (ZVA) përkatëse. Gjatë procesit të

provimit u zbatuan të gjitha rregullat e protokollit të përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; si distancimi fizik dhe përdorimi i masave mbrojtëse.

Emergjecat Civile

Nisur nga përvoja e deritanishme dhe problematikat e krijuara nga emergjencat civile, kryesisht përmbytjet, pasi hapësira territoriale-administrative e Qarkut Durrës bën pjesë tek zonat me nivel risku të lartë, u komunikua me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore për njoftimin e Ministrisë së Mbrojtjes për të aplikuar për programin “*Fondi për Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore*” nëpërmjet Komitetit për Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore ky fond shpërndahet për njësitë e vetëqeverisjes vendore nga Ministria e Mbrojtjes, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Më datë 06.05.2022, u organizua mbledhja e Komisionit të Mbrojtjes Civile në nivel qarku, në lidhje me “Marrjen e masave në planifikimin dhe përballimin e emergjencave gjatë sezonit pranverë-verë 2022”. Qëllimi i takimit ishte marrja e masave konkrete dhe reaguese nga Bashkitë dhe institucionet në Qark për parandalimin dhe përballimin e emergjencave verore 2022 (zjarret, minimizimin e dëmeve dhe përballimin e situatës që mund të krijohet). Në këtë takim u bë një analizë e përmbledhur e situatës në Qarkun e Durrësit duke vlerësuar punën dhe angazhimin e të tre Bashkive. U trajtuan problematikat e krijuara nga zjarret gjatë sezonit të kaluar si dhe puna e bërë nga strukturat përgjegjëse që kanë të bëjnë me mbrojtjen civile.

Gjithashtu, ju kërkua strukturave përgjegjëse vendore ndjekja me prioritet dhe në vazhdimësi, e çështjeve, si më poshtë:

- Përditësimi i skemave të informimit për mënyrën e komunikimit, të strukturave të M.Z.SH, Policisë së Shtetit, Shërbimit Pyjor dhe strukturave të tjera të parashikuara, me qëllim informimin, koordinimin dhe ndërhyrjen në kohë të mjeteve tokësore, ajrore dhe forcave operacionale për vënien nën kontroll të zjarreve të mundshme dhe rikthimin në situatë normale.
- Rishikimin dhe përditësimin e planeve të gatishmërisë për emergjencat sezonale verore, duke bërë plotësimet dhe përditësimet e nevojshme;
- Bashkëpunimin me njësitë administrative për ngritjen nëçdo fshat të grupeve (skuadrave) vullnetare për shuarjen e zjarreve, të cilat duhet të jenë të trajnuara nga strukturat e M.Z.SH që veprojnë pranë bashkie;
- Evidentimin e blegtorëve dhe zonat që përdoren prej tyre si kullota, si dhe fermerët që kanë plantacione frutikulture, me qëllim marrjen e masave parandaluese dhe rritjen e kujdesit për parandalimin e zjarreve;
- Vendosja e tabelave sinjalizuese në rrugët me destinacion zonat turistike, ku mundësia e rënies së zjarreve është e lartë;
- Përcaktimi i vendfurnizimeve me ujë të mjeteve ajrore që mund të përdoren për shuarjen e zjarreve;
- Bashkëpunimin në mënyrë të veçantë me strukturat e Policisë së Shtetit, për identifikimin dhe vënien përpara përgjegjësisë penale të autorëve zjarrvënës.

Më datë 22.07.2022, u mbajt në ambientet e Institucionit të Prefektit mbledhja e thirrur nga Prefekti i Qarkut në bashkëpunim të ngushtë me Kryetarin e Komitetit Kombëtar të Digave të mëdha dhe Drejtorin e Drejtorisë së Gadishmërisë dhe Koordinimit të Emergjencave Civile.

Duke marrë shkas nga situata tejet e rënduar si pasojë e zjarreve të rëna, prej muajit korrik e në vazhdim, u organizua një takim në datën 11.08.2022 me të gjitha strukturat përgjegjëse në fushën e emergjencave civile, për të bërë një analizë të punës në lidhje me menaxhimin e emergjencave civile në territorin e qarkut Durrës, në zbatim të detyrave të ngarkuara nga legjislacioni në fuqi, në fushën e emergjencave civile. Qëllimi i takimit ishte analiza e thelluar e situatave të deritanishme të zjarreve, problematikat dhe masat shtesë që duhen të merren për parandalimin dhe rritjen e efikasitetit të reagimit nga strukturat përgjegjëse në bashkëpunim me komunitetin dhe strukturat.

Në datën 05.10.2022, u mbajt një takim në kuadër të hartimit të *“Planit Kombëtar të Emergjencave Civile”* në zbatim të Urdhërit të Kryeministrit nr.58, datë 29.06.2021 *“Për ngritjen e Grupit Ndërinstitucional dhe Grupit Teknik të Punës për përgatitjen e projektit të Planit Kombëtar për Emergjencat Civile”*. Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile në cilësinë e autoritetit më të lartë koordinues, bashkërendues, drejtues teknik, mbikëqyrës dhe kontrollues në fushën e zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, udhëheq punën për hartimin e *“Strategjisë Kombëtare të Zvogëlimit të Riskut nga Fatkeqësitë”*, *“Vlerësimit të Riskut nga Fatkeqësitë në Nivel Qëndror”*, si dhe *“Planit Kombëtar për Emergjencat Civile”* për të kompletuar paketën e 3 (tre) dokumentave bazë, për të bërë të mundur rritjen e efikasitetit të Sistemit të Mbrojtjes Civile, në lidhje me parandalimin, parapërgatitjen, përballimin dhe minimizimin e dëmeve nga rreziku i emergjencave civile. Ky proces po mbështetet nga projekti *“Resilience Strengthening in Albania – Reseal”* implementuar nga UNDP, me ekspertë kombëtarë dhe ndërkombëtarë, në bashkëpunim të ngushtë me strukturat e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile.

Në kuadër të projektit TO BE READY, me qëllim ndërtimin e një fushate sensibilizuese lidhur me riskun si dhe mbrojtjen ndaj zjarreve, u zhvilluanë datën 26.10.2022, ora 10:00, një takim me përfaqësues nga të 3 (tre) bashkitë, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, ekspertë kombëtarë. Objekti i diskutimit, ishte fenomeni i zjarreve në pyje, kullota, toka bujqësore, bimësi të ulët, etj., incidencën, riskun, shkaqet si dhe mundësitë e parandalimit. Aktualisht, projekti ndodhet në fazën e mbledhjes së informacionit nga strukturat përgjegjëse, si dhe nga publiku i gjerë.

Në kuadër të operacionit për kërkimin, zbulimin dhe grumbullimin e municioneve të paplasura (UXO), të cilat gjenden në ishpoligonin e qitjes, në zonën e Jub-Sukthit, Njësia Administrative Katund i Ri, Bashkia Durrësme qëllim kthimin në zonë të sigurtë për përdorim nga autoritetet lokale në datën 03.11.2022, u zhvillua një takim në terren me efektivistët e Forcat e Armatosura të Shqipërisë Forca Tokësore (Kompania e Xhenios). Puna për pastrimin e zonës, zhvillohet në një hapësirë prej 42 ha për të cilën është vendosur perimetri i sigurisë. Janë gjetur një sasi municionesh dhe është bërë e mundur heqja e tyre nga zona. Efektivët e angazhuar në operacion, vijnë punën me intensitet të lartë.

Duke pasur parasysh rëndësinë e digave dhe kërkesën emergjente për rehabilitimin e tyre para sezonit të reshjeve në datën 11.11.2022 u organizua një takim pranë Bashkisë Shijak me Kryetarin e Bashkisë Shijak dhe Kryetarin e Komitetit Kombëtar të Digave të Mëdha. Legjislacioni në fuqi

shprehet se përgjegjësi kryesor për sigurinë e digave dhe pasojat që rrjedhin nga prishja e mundshme e tyre është Bashkia Shijak, si shfrytëzuese e digave.

Më datë 20.11.2022 u thirr mbledhja jashtë rradhe e Komisionit të Mbrojtjes Civile në nivel qarku, për të diskutuar rreth situatës së krijuar nga rreshjet me intensitet shumë të lartë, ku niveli i riskut për përmbytje është i lartë. U rakordua mbi planin e masave parandaluese dhe lehtësuese për menaxhimin e situatës edhe në orët në vijim, që sipas parashikimit të motit do të jenë me reshje të shumta. Në datën 05.12.2022, u zhvillua një takim në kuadër të bashkëpunimit mbështetës me përfaqësues nga Drejtoria e Bashkëpunimit Civilo-Ushtarak, Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, Ministria e Mbrojtjes; Detashmenti CIMIC; Seksioni i Policisë Ushtarake Durrës; Seksioni i Rekrutimit Durrës. Në takim u diskutua për rritjen e nivelit të bashkëpunimit reciprok në interes të përmbushjes së detyrave të përbashkëta dhe të misionit Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, si dhe u shpreh nevoja e shkëmbimit të informacionit të ndërsjellë me institucionet përkatëse.

Në zbatim të Urdhrit të Ministrit të Mbrojtjes nr. 1861, datë 24.10.2022 *“Për organizimin, planëzimin dhe zhvillimin e stërvitjes të koduar SEESIM 22”*, duke pasur parasysh se në datat 13-16 dhjetor 2022, do të zhvillohet stërvitja e koduar “SEESIM 22”, e cila ka për qëllim të forcojë bashkëpunimin, koordinimin dhe ndërveprueshmërinë e operacioneve civilo-ushtarake, si dhe përgjigjen ndaj fatkeqësive reale brenda dhe midis vendeve të *“SEDM-Komiteti Koordinues Ministror i Mbrojtjes për Europën Juglindore”*, nëpërmjet përdorimit efektiv të modelimit dhe simulimit kompjuterik (M&S), morrëm pjesë nga data 13-16 dhjetor, për të zbatuar detyrat e përcaktuara sipas skenarit të përgatitur nga Drejtoria e Gatishmërisë dhe Koordinimit të Përgjigjes Emergjente të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile.

- Në të gjithë qarkun Durrës numri total i operacioneve të ndërhyrjes nga shërbimi zjarrfikës është 1487;
- Pjesa dërmuese e zjarreve ka qenë zjarrvënie e qëllimshme nga ana e banorëve të zonës, kryesisht për pastrimin e arave;
- Policia e shtetit duhet të jetë më efikase në zbulimin e autorëve zjarrvënës, duke rritur nivelin e bashkëpunimit me kryetarët e fshatrave dhe strukturave të tjera.

Argjinaturat dhe pastrimi i kanaleve të para, të dyta dhe ujërave të larta.

Sektori i Planifikimit, Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave kanë kryer inspektimin në terren të punës në lidhje me pastrimin e kanaleve të para, të dyta dhe ujërave të larta, që janë nën administrimin e Bashkive dhe Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit. Menaxhimi i kanaleve në kohën e duhur, para fillimit të rreshjeve, bërithmundur rritjen e efikasitetit të çdo strukture, për parandalimin, parapërgatitjen, përballimin dhe minimizimin e dëmeve nga rreziku i përmbytjeve.

- Gjatësia e kanaleve të pastruara nga Njësitë e Vetqeverisjes Vendore dhe Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Durrës për vitin 2022 është 111,959ml, duke pasur një rritje prej 34,414ml, krahasuar me vitin 2021;

- Bashkia Durrës me qëllim uljen e riskut në zonat me nivel risku për përmbytje si pasojë e daljes nga shtrati të lumit Erzen, është ndërtuar argjinatura e lumit Erzennë fshatin Katund i Ri me gjatësi 500ml, si dhe argjinatura në Sukth me një gjatësi prej 650ml.

Situatat më emergjente dhe problematike

Gjatë sezonit të verës, me rritjen e temperaturave, rritjen e fluksit të lëvizjes së njerëzve, mjeteve, intensitetit të punës nga ana e operatorëve turistikë u regjistruan një numër zjarresh, konsiderueshëm i lartë, në raport me të njëjtën periudhë të vitit 2021. Vlen për tu falenderuar puna e mirë nga ana e forcave zjarrfikëse.

Si pasojë e rreshjeve me intensitet të lartë, **gjatë periudhës 20-24 nëntor**, zonat e prekura ishin:

Fshatrat Murqinë, Bilaj të Njesisë Administrative Bubq, Bashkia Krujë si pasojë e daljes nga shtrati të lumit Ishëm sipërfaqja e përmbytur nga uji ishte rreth 150 (njëqind e pesëdhjetë) ha, kryesisht toka bujqësore, akse rrugore rurale. Falë thirrjes për bashkëpunim të ngushtë, nga Prefekti i Qarkut drejtuar Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit me strukturat përgjegjëse vendore, u bë e mundur ndërhyrja në kanalën e madh shkarkues në lumin Zezë;

Rajoni nr. 6, qyteti Durrës, Bashkia Durrës, kryesisht në zonën e Porto Romanos dhe ishkeneta (zona problematike nisur edhe nga përvojat e viteve të kaluara), për shkak se ka banesa të ndërtuara në nivelin e detit, si dhe mungesës së një rrjeti të mirëfilltë kanalizimesh, pati përmbytje në 8 (tetë) banesa, ndërsa në 12 (dymbëdhjetë) banesa të tjera pati prani uji në oborret e tyre. Pas kërkesës së Administratorit të Rajonit nr.6, në bashkëpunim të ngushtë me Autoritetin Portual, M.Z.S.H-në dhe Ujësjellës-Kanalizime Durrës u bë e mundur heqja e ujit nga banesat;

Nga fatkeqësia natyrore e përmbytjet e datës 10-13 dhjetor 2022 si pasojë e daljes nga shtrati të lumit Ishëm dhe Erzen, duke pasur parasysh rolin e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile në cilësinë e autoritetit më të lartë koordinues, bashkërendues, drejtues teknik, mbikëqyrës dhe kontrollues në fushën e zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, si dhe të Rezervave Materiale të Shtetit për të ndërhyrë në mënyrë operative, për mbrojtjen e popullsisë, të ekonomisë në situata të gjendjes së emergjencës civile, të cilat sjellin dëme të menjëhershme për jetën, shëndetin e popullatës dhe të gjësë së gjallë, pasurinë, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin, iu kërkua ndihmë me pako ushqimore dhe joushqimore për familjet e prekura nga përmbytjet.

Problematikat e lindura

Mos funksionimi në mënyrën e duhur të skemës së lajmërimit në momentin e ndodhjes të situatës emergjente; Pavarësisht rekomandimeve të shumta, në zbatim të ligjit, drejtuar strukturave përgjegjëse, përsëri raportimi në kohë ka çaluar, për pasojë reagimi i forcave zjarrfikëse ka qenë i vonuar; Në të treja bashkitë nuk ka një plan për rinovimin e mjeteve që shërbejnë gjatë emergjencave civile për shkak se mjetet aktuale anë në gjëndje të amortizuar (mjete zjarrfikëse, pompa të kapacitetit të lartë, makinë vetshkarkuese, sharra, etj.); Në lidhje me strukturën e cila mbulon fushën e mbrojtjes civile, Bashkia Durrës, si bashki e nivelit të parë, qëndër qarku nuk e ka në nivel drejtorie, ndërsa Bashkia Krujë dhe Bashkia Shijak e ka në nivel sektori; Mungesa e rifreskimit të planeve të gadishmërisë në situatë emergjence për të gjitha strukturat

përgjegjëse; Mungesa e planizimit për ngritjen e argjinaturave, në zonat me risk të lartë përmbajtje, mungesa e fondit ka bërë që Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Durrës, të mos i përmbushë të gjitha kërkesat e ardhura nga ana e Njësive të Vetqeverisjes Vendore.

Mospërdorim i fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile alokuar Njësive të Vetqeverisjes Vendore me anë të VKM-së nr. 414, datë 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”.

Gjatë këtij viti Këshilli i Basenit Ishëm ka realizuar 5 mbledhje 19 vendime gjithsej.

Nga keto:

9 miratim leje kryerje pus shpimi

1 vendim është konstituim i Kbu-së

1 vendim transferim leje

1 vendim refuzim kërkesë shpim pusi

3 vendime miratim leje përdorimi sanitare

2 vendime miratim leje ujë industrial

1 vendim miratim leje qëllim kurative

1 vendim rinovim leje prodhim pije alkolike.

Objektivat janë:

Relaizimi i 6 mbledhjeve në vit (Janë bërë 5) pasi dhe aplikime nuk ka patur shumë.

Nxjtja e përdoruesve të ujit me leje në bashkëpunim me ZABU-në

Konsultimi i planit të menaxhimit të Basenit Ishëm para se të miratohet në Këshillin kombëtar të Ujit.

Marrja e informacionit nga ZABU si sekretariat teknik në lidhje me përdoruesit e burimeve ujore me leje ose pa leje dhe ngritja e shqetësimeve në mbledhjet e KBU-së.

V. Për urdhërat dhe udhëzimet e nxjerra nga Prefekti.

Në zbatim të ligjit 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” neni 20, gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2022 Institucioni i Prefektit ka nxjerrë **98** Urdhëra të ndryshëm me karakter administrativ.

Gjendja Civile.

Në zbatim të Ligjit Nr. 10129, datë 11.05.2009” Për Gjendjen Civile” zyra e arkivit të gjendjes civile ka lëshuar çertifikata të shërbimit të gjendjes civile, duke plotësuar kërkesat e shtetasve për akte trashëgimie 2550 për sigurime shoqërore dhe shëndetsore 270 , për jashtë shtetit e për bashkim familjar 449, për arësye të ndryshme 370, për efekte gjyqësore 220, për dëmshpërbim për të persekutuarit politik 15.

Në mbështetje të Ligjit Nr.130/2013 janë lëshuar çertifikata për efekt korrigjimi të gabimeve materiale, për ndreqjen e të dhënave në rregjistrat e zyrave të gjendjes civile pranë njësive

administrative përkatëse (320), si dhe fotokopjet e fletëve të rregjistrave përkatës. Mbi sasinë e certifikatave të përdoruara sipas numrit të serisë janë mbajtur evidenca të sakta (4120fletë).

Sektori i Financës dhe i Shërbimeve Mbështetëse

Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, pranë Prefektit të Qarkut Durrës, gjatë vitit 2022 e kambështeturpunën e saj në zbatim të ligjshmërisë dhe objektivave të shtruar për realizimin e tyre në të gjithë veprimtarinë e këtij sektori, në zbatim të ligjit “Për Prefektin e Qarkut”, të ligjit “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” si dhe ligjeve e udhëzimeve specifike në fushën e financës. Në zbatim të saj kemi patur bashkëpunim dhe me sektorët e tjerë të Prefekturës si dhe në kontakt e ndjekje të vazhdueshme dhe me njesitë e qeverisjes vendore në zbatim të kërkesave të reja të menaxhimit dhe efikasitetit më të mirë të burimeve financiare të vëna në dispozicion nga ana e buxhetit të shtetit. Në këtë periudhë, detyrat para punonjësve të Sektorit të Financës ishin në realizimin me efikasitet dhe kompetencë profesionale të gjithë aktivitetit të tyre. Sektori i Financës që në fillim të vitit në bashkëpunim me sektorët përkatës të Prefekturës Qarkut Durrës, bëri detajimin e buxhetit të vitit 2022 si dhe dha ndihmën parësore dhe për tre Bashkitë, me qëllim që detajimi dhe vënia në zbatim e këtij buxheti të bëheshin saktësisht dhe në kohë. Kjo është kryer si me detajimet buxhetore, paketat fiskale, mbylljet vjetore apo ndjekjen e problematikave që shfaqeshin vazhdimisht në këto njësi. Po në këtë këndvështrim u punua dhe u krye dhe mbyllja e rezultatit ekonomik të Prefekturës si dhe u hartua programi vjetor i punës për vitin 2022. Brenda muajit Janar 2022, u detajua buxheti i ri për vitin 2022 për administratën e Prefektit dhe Gjendjen Civile. Po kështu u hartuar Rregjistri i realizimit të Prokurimit Publik për vitin 2021 si dhe u hartuar e miratua Rregjistri i parashikimit të Prokurimit Publik për vitin 2022 të cilët u dërguan brenda afatit në Ministrinë e Brendshme dhe Degën e Thesarit. Në zbatim të Urdhërit nr.1 protodatë 07.01.2022 të Prefektit të Qarkut Durrës është përcaktuar struktura e administratës së Prefektit me 28 punonjës, (bashkë me 2 punonjës të gjendjes civile) sipas pozicioneve të punës dhe me emrat e punonjësve. Nga DAP janë hapur procedurat dhe është bërë emërimi në muajin shkurt 2022 për specialistin në Sektorin e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse. Gjatë gjithë kësaj periudhe kanë qenë në marrëdhënie pune 25 punonjës, për të cilët janë kryer në afat hartimi i listave, përlllogaritja e kontributeve dhe tatimit, përpilimi i urdhër shpenzimeve si dhe ndjekja e pagesave në Thesar dhe Bankë. Mbeten dhe tre vende vakant; 1 Sekretari i Përgjithshëm i Prefekturës dhe 2 specialistë në Sektorin Juridik.

Gjatë vitit 2022, Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, ka ndjekur përdorimin dhe administrimin e fondeve të vëna në dispozicion për aparatin e Prefekturës dhe atë të Gjendjes Civile. Kemi raportuar çdo muaj, evidencat e realizimit të treguesve buxhetorë në Ministrinë e Brendshme dhe në Degën e Thesarit. Në buxhetin e vitit 2022, në total ku përfshihet Prefektura dhe Gjendja Civile, gjithsej janë 30,646,100 lekë, ku peshën më të madhe e zënë shpenzimet për paga të personelit në masën 20,195,000 lekë ose 65,9 %, kontributet për sigurimet shoqërore e shëndetësore 3,593,000 lekë ose 11,73 %, shpenzimet për mallra e shërbime 6,344,800 lekë ose 20,7%.

Ana kryesore e punës së institucionit të Prefektit është menaxhimi sa më racional i këtyre fondeve.

Në vitin 2022 realizimi i fondeve buxhetore është në masën 92 %, ose nga 30.646 mijë lekë të planifikuara në fakt janë shpenzuar 28.101 mijë lekë, pra më pak 2.545 mijë lekë. Sipas zërave përkatës shohim që pagesat për personelin u realizuan 95 % ose 993, lekë më pak. Ky kursim ka ardhë si pasojë e vendeve të pa plotësuara në organikë, e për rrjedhojë dhe kontributet për sigurimet shoqërore e shëndetësore u realizuan në masën 89%. %, pra më pak 408 mijë lekë, kursim ky që lidhet me kursimin e fondit të pagës. Për mallra e shërbime të tjera realizimi ishte në masën 82%. % ose nga 6,344,800 lekë në 5,200,614 lekë, pra më pak 1.144 mijë lekë. shpenzime janë realizuar në masën 82%. Konkretisht nga 6.345mijë lekë të planifikuara në fakt janë shpenzuar 5.201mijë lekë, pra më pak 1.144mijë lekë. Ky mos realizim i shpenzime ka ardhë si rezultat i mos realizimit të procedurave të prokurimit në shumën prej 704 mijë lekë si dhe kursimi nga konkurrenca e bërë nga zhvillimi i procedurave të prokurimit në shumën prej 210 mijë lekë si dhe në shumën prej 230 mijë lekë nga kursimi i shpenzime si shërbime nga të tretët, shpenzime udhëtimi dhe të tjera operative. Duke i analizuar shpenzimet operative sipas strukturës ato paraqiten si më poshtë:

- Materiale zyre dhe të përgjithshme, (kancelari, materiale pastrim e dezinfektimi, materiale për funksionimin e pajisjeve të zyrës, furnizime e materiale të tjera zyre), janë realizuar 94% ;
- Shërbimet nga të tretët (telefona, energji, ujë, shërbim postar, ruajtje fizike e godinës, faqja zyrtare, shërbim interneti dhe shërbime të tjera), janë realizuar 96%, të cilët zënë peshën kryesore të këtyre shpenzimeve në masë (69.3%);
- Shërbimet e transportit (naftë, pjesë këmbimi), janë realizuar 94.6%;
- Shpenzime udhëtimi janë realizuar 5% ;
- Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme janë realizuar 27%;
- Shpenzime të tjera operative janë realizuar 47%;

Është bërë ndjekja e realizimit të Ardhurave për periudhën Janar-Dhjetor 2022 të cilat raportohen për çdo muaj në Ministri dhe janë të konfirmuara nga Dega e Thesarit Durrës. Për këtë periudhë të ardhurat janë realizuar në total 551.000 lekë, nga të cilat 27.550 lekë, të ardhurat për Ministrin e Brendshme dhe 523.450 lekë, të ardhurat për Buxhetin e Shtetit.

Gjatë këtij viti së bashku me komisionet përkatëse (komisioni i testimit, prokurimit dhe ai i marrjes në dorëzim), janë realizuar 12 procedura prokurimi me vlerë të vogël, nga 15 të planifikuara. Nga procedurat e parë realizuara janë shpenzime për mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore, shpenzime për të tjera materiale dhe shërbime operative si dhe të tjera materiale dhe shërbime speciale. Gjithashtu është dërguar në APP Regjistri i realizimit të procedurave të prokurimit publik për çdo katër muaj si dhe ai vitit 2022.

Është realizuar mbajtja e sistemit të kontabilitetit të vlerave monetare dhe materiale, lëvizja e aktiveve, raportim për vendimarrjen në funksion të realizimit të objektivave, përgatitja e pasqyrave financiare të institucionit dhe depozitimi në degën e thesarit dhe Ministrinë e Brendshme. Përpunimi dhe shpërndarja e korrespondencës, nisja brenda afateve kohore të të gjithë dokumentacionit që del nga institucioni si dhe përgatitje dhe dërgimi i evidencave statistikore tre mujore Zyrës Rajonale të Statistikës Durrës. Është bërë shpallja e vendeve të punonjësve me status nëpunësi në sistemin HRMIS sipas kritereve të kërkuara në zbatim të Ligjit 152/2013 “Për statusin e nëpunësit civil” për -3

pozicione; nga këto 2 kategori ekzekutive+1 drejtues i ulët. Është bërë hedhja e të dhënave të dosjeve individuale në këtë sistem dhe po punohet akomapër pasqyrimin e pervojës së punës duke ndjekur trajnime periodike pranë shkollës ASPA.

U krye raportimi vjetor i nevojave për rekrutim në Ministrinë e Brendshme, si dhe gjendja mbi zbatimin e Ligjit 152/2013 "Për statusin e nënpunësit civil" tek Komisioneri për Mbikqyrjen e Shërbimit Civil. Janë nxjerrë urdhërat për 2 automjetet në dispozicion të administratës së Prefektit duke zbatuar Urdhrin e Ministrit të Brendshëm nr.112, dt.18.04.2014 "Për përcaktimin e numrit të automjeteve dhe shoferëve si dhe disa rregulla për përdorimin e tyre", në zbatim të tij është bërë dhe plotësimi ditor i fletë-autorizimeve të punonjësve të administratës, si dhe plotësimi mujor i fletë-udhëtimeve të shoferëve të automjeteve.

Nga ana e Arkiv-Protokollit janë kryer çdo ditë të gjitha veprimet për pranimin, rregjistrimin, ciklimin dhe shpërndarjen e korespondencës në bazë të Ligjit nr.9154 të vitit 2003 "Për fondin arkivor kombëtar dhe për arkivat" si dhe rregullave të përcaktuara në rregulloren e Prefektit. Gjatë vitit 2022, janë protokolluar 960 shkresa, praktika të ndryshme për shqyrtim nga Këshilli Ministrave, Bashkitë dhe Administrata Shtetërore në nivel lokal. Është kryer menaxhimi dhe administrimi i faqes zyrtare të Prefekturës. Janë realizuar në total 57 aktivitete dhe takime të ndryshme, të cilat janë publikuar si në faqen zyrtare dhe në rrjetet sociale. Disa probleme që kanë dalë gjatë vitit, ku një pjesë e të cilave janë realizuar, në funksion të realizimit të detyrave si dhe për një funksionim më të mirë e më efikas të punës në Sektorin e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse si dhe në atë të administratës së Prefektit. Në drejtim të krijimit të kushteve më të mira në ambientet e zyrave të Prefekturës, si pasojë tërmetit të nëntorit të vitit 2019 janë të dëmtuara dhe amortizuara tualetet e Institucionit për të cilat janë kërkuar fonde për investime për rikonstruksionin e tyre në buxhetet e viteve të mëparshme, mendojmë që ky problem do të realizohet me fondet të planifikuara për vitin 2023. Po kështu do të bëjmë të mundur për këtë vit dhe përmirësimin për mirë funksionimin e disa zyrave me paisje zyrash.

Legalizimi i dokumentave.

Bazuar në VKM Nr.134 datë 07.03.2003 "Për vërtetimin dhe legalizimin e dokumentave të lëshuara në Republikën e Shqipërisë për përdorim jashtë vendit dhe të dokumentave të huaja për përdorim brenda vendit" janë legalizuar **16 628** dokumenta të lëshuara nga organet e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore.

Shqyrtimi i kundravajtjeve administrative në fushën e qarkullimit rrugor.

Në lidhje me kundravajtjet administrative, në zbatim të Udhëzimit Nr.687 datë 05.12.2013 "Për mënyrën e evidentimit dhe shqyrtimit të kundravajtjeve administrative, procedurat që ndiqen për masat administrative plotësuese dhe administrimi i gjobave në fushën e qarkullimit rrugor" janë shqyrtuar **39** praktika shkresore të dërguara nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Durrës.

PREFEKTI
EMILIAN JANI

Konceptoi: A. Murto

Pranoi: E. Çato

Konfirmoi: S. Zeqja

V. Rustani

L. Zeka

A. Lekbello

D. Polena

PREFEKTI I QARKUT DURRËS

EVIDENCË PËR AKTET NORMATIVE TË ORGANEVE TË VETËQEVERISJES VENDORE

Viti 2022

Verifikimi i Ligjshmërisë së Akteve të Organeve të Vetëqeverisjes Vendore										Verifikimi i Ligjshmërisë së Akteve të Organeve të Vetëqeverisjes Vendore
Nr.	Njësi të vetëqeverisjes vendore	Akte të hyra tek Prefekti		Të bazuara në ligj		Të pabazuara në ligj		Të rishqyrtuara nga Nj.Q.V		Verifikimi i Ligjshmërisë së Akteve të Organeve të Vetëqeverisjes Vendore
		Muj.	Prog.	Muj.	Prog.	Muj.	Prog.	Muj.	Prog.	
1	Këshilli i Qarkut Durrës		26		17		2		-	
2	Bashkia Durrës		157		121		4		-	
3	Bashkia Krujë		104		94		-		-	
4	Bashkia Shijak		69		54		2		-	
Shuma			356		286		8		-	

Gjatë vitit 2022 për Këshillin e Qarkut janë vlerësuar 7 akte me karakter individual.

Gjatë vitit 2022 për Bashkinë Durrës janë vlerësuar 32 akte me karakter individual

Gjatë vitit 2022 për Bashkinë Krujë janë vlerësuar 10 akte me karakter individual

Gjatë vitit 2022 për Bashkinë Shijak janë vlerësuar 13 akte me karakter individual

Gjithsej 62 akte me karakter individual.